



AVANCIMI I ZHVILLIMIT  
RAJONAL  
2017-2021

Ministria e Zhvillimit Rajonal

Ky dokument mbështetet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) dhe është hartuar dhe kryesuar nga Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio Ekonomike Rajonale (DPASER) me përkrahje nga Grupi Punues, Agjencitë për Zhvillim Rajonal, AZHR Qendër, AZHR Lindje, AZHR Veri, AZHR Perëndim, AZHR Jug dhe konsulenti nga GIZ-së Z. Berat Abdiu

Përshkrim i rolit, qëllimeve dhe arritjeve të MZHR në avancimin e zhvillimit të balancuar rajonal gjatë periudhës 2017 - 2021

DHJETOR, 2022

## Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive.....	1
Hyrje .....	2
Rajonet zhvillimore .....	4
Dokumentet strategjike dhe aktet ligjore.....	5
Koncept dokumenti.....	6
Strategjia për Zhvillim Rajonal (2020 – 2030).....	7
Projektligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar.....	9
Korniza e akteve, mekanizmave dhe veprimeve .....	10
Analizat Socio-ekonomike.....	12
Programet e MZHR-së dhe rezultatet.....	17
Programi për Zhvillim Rajonal (PZHR) .....	18
Programi për Mbështetjen e Zhvillimit Rajonal të Balancuar (PZHRB).....	19
Programi për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar .....	20
Përmbledhja e programeve dhe buxheteve .....	24
Struktura e MZHR dhe arritjet.....	26
Organizimi i MZHR .....	27
Arritjet e MZHR-së në avancimin e zhvillimit rajonal.....	28
Bashkëpunimi me akteret tjerë .....	30
Donatorët .....	30
Institucionet vendore .....	35
Ministritë e Linjes.....	35
Komunat .....	36
Agjensionet për Zhvillim Rajonal (AZHR-të).....	36
Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të).....	38
Organizatat tjera.....	38

## Përmbledhja ekzekutive

Ministria e Zhvillimit Rajonal e themeluar në vitin 2017 dhe operationale prej vitit 2018, shquhet me rezultate të prekshme dhe të arritura gjatë periudhës 2018 – 2021. E themeluar me mandat për hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillim të balancuar të rajoneve zhvillimore në Kosovë, ministria njëherazi zbaton edhe pjesë të obligimeve që rrjedhin nga agjenda e integritimeve EU e që burojnë nga MSA.

Vlerësimi i arritjeve në fushën e zhvillimit të rajoneve zhvillimore për periudhën 2018 – 2021, implikohet edhe vlerësimi i ndërtimit dhe ngritjes së kapaciteteve të vet MZHR më saktësisht, vlerësimi i arritjeve zhvillohet në kontekst të vlerësimit të përmbushjes së mandatit i cili është formësuar në koncept dokumentin për MZHR të vitit 2018.

Pasqyruar në shifra, Ministria e Zhvillimit Rajonal gjatë periudhës 2017 – 2021 ka zbatuar programe për mbështetjen e aktiviteteve për zhvillim rajonal, në vlerën totale prej EUR 15.64 milion këto të disbursuara sipas rajoneve zhvillimore dhe viteve. Përkatësisht EUR 2.98 milion në vitin 2018, EUR 4.48 milion në vitin 2019, EUR 5.48 milion në vitin 2020 dhe EUR 2.73 milion në vitin 2021. Në këto llogaritje të disbursimeve hyjnë edhe masat e Programit për Rimekmbje (Masa 8 dhe Masa 15) për vitet 2020 dhe 2021.

Për më shumë MZHR gjatë periudhës së vlerësuar ka arritur rezultat në përmbushjen e objektivave në katër shtylla:

- Ngritjen e mekanizmave institucional dhe zhvillimin e kapaciteteve për ushtrim të përgjegjësi – MZHR në tërësinë organizative;
- Hartimi dhe zbatimi i politikave për zhvillim rajonal të balancuar: Koncepti dokumenti, Strategjia 2020 – 2030 dhe Plani i Veprimit; Projekt Ligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar;
- Hartimi dhe zbatimi i mekanizmave/programeve për mbështetjen e zhvillimit rajonal: Programi për Zhvillim Rajonal (PZHR), Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) dhe Programi për mbështetjen e OSHC-ve në promovim të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve;
- Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve për koordinim dhe sigurimin e mbështetjes për MZHR-në në zhvillimin e balancuar të rajoneve zhvillimore, ngritja e programeve të rregullta në tre (3) fusha specifike duke vazhduar me bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare, organizata donatore dhe agjencione ndërkombëtare për zhvillim si dhe me OSHC-të lokale dhe ndërkombëtare. Bashkëpunimi dhe koordinimi me ministritë e tjera dhe agjencione të Qeverisë së Kosovës si Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK). Sigurimi i koordinimit dhe ndihmës nga organizatat tjera është bërë me qëllim të zbatimit të obligimeve nga agjenda integruese në BE – MSA (sistemimi i organizimit të rajoneve zhvillimore sipas NUTS në bashkëpunim me ASK), si dhe sigurimi i përgatitjes së treguesve për matjen e shkallës së zhvillimit socio – ekonomik në nivel të rajoneve (ASK), hartimi i dokumentit për ngritjen e sistemit për monitorimin e shkallës së zhvillimit socio-ekonomik.

Poashtu në vazhdimësi MZHR ka përgatitur dhe publikuar dokumente analitike, si raporte të punës, raporte analitike dhe përmbajtësore lidhur me aktivitetet dhe arritjet, si dhe raporte për projektet dhe buxhetet e disbursuara sipas rajoneve zhvillimore. Në vazhdimësi ka përgatitur

dhe publikuar dokumentet themelore si Koncept Dokumentin dhe Strategjinë e MZHR-së (2020-2030). Shpalosja dhe komunikimi i rregullt dhe përmbajtësor i ka kontribuar transparencës si dhe pasqyrimin të qasjes së balancuar në aspektin e alokimit të resurseve dhe përcaktimin e prioriteteve si nga ana e MZHR e poashtu edhe nga ana e Ministrive të Linjës.

## Hyrje

Dokumenti Avancimi i Zhvillimit Rajonal 2017 – 2021 është përpiluar me qëllim të shpalosjes dhe pasqyrimin të punës dhe arritjet e Ministrisë për Zhvillim Rajonal (MZHR) në hartimin dhe zbatimin e politikave për sigurimin e zhvillimit të balancuar të rajoneve zhvillimore. Raporti kufizohet në periudhën kohore prej themelimit të MZHR-së deri në vitin 2021. Ndonëse në aspektin e shpalosjes MZHR përgatit dhe publikon rregullisht raporte dhe analiza financiare duke paraqitur në vazhdimësi informata lidhur me projektet dhe aktivitetet e tjera përmbajtësore. Ky raport pasqyron progresin e arritur gjatë viteve duke shpalosur avancimin drejt përmbushjeve në drejtimet strategjike dhe arritjet e shënuara. Raporti fillon me përshkrim të shkurtër të kontekstit, historikun e konceptit të zhvillimit rajonal në Bashkimin Europian si dhe atë në Kosovë, duke vazhduar më tej me konceptin e MZHR-së, planin strategjik dhe qasjen programatike si dhe analizën e arritjeve për avancimin e zhvillimit rajonal të balancuar.

Politikat rajonale të Bashkimit Europian (BE) të referuara poashtu edhe si politikat e kohezionit janë politika të cilat kanë për qëllim përmirësimin e mirëqenies ekonomike të rajoneve të Bashkimit European dhe uljen e dispariteteve rajonale.

Prej momentit të nënshkrimit të Traktatit të Romës më 1957 (akti themelues i Komunitetit Ekonomik Europian), një nga detyrat kryesore të bashkimit ka qenë promovimi i “*zhvillimit të harmonizuar të aktiviteteve ekonomike*”. Në raportet e Komisionit në komunikatën e parë në vitin 1964 dhe në rekomandimin në vijim në vitin 1969 paraqitet nevoja për një zgjedhje për të siguruar një komunitet të koordinuar lidhur me problemet rajonale dhe korrigjimin e pabarazive rajonale.

Konteksti Europian institucional dhe politik lidhur me zhvillimin e balancuar të rajoneve ka një histori tanimë pothuajse 60 vjeçare me një korpus të gjërë dhe të thellë të strategjive, dokumenteve politike, instrumenteve ligjore si dhe të institucioneve politikëbërëse dhe zbatuese, të cilat poashtu sigurohen edhe për koordinim me politikat tjera nacionale dhe ato të përbashkëta, të shoqëruara poashtu edhe me ndarje përkatëse buxhetore. Përmbledhja e historisë së BE-së lidhur me politikat për zhvillim rajonal të balancuar (politikat e kohezionit) si dhe konteksti aktual përshkruhen në koncept dokumentin të MZHR të vitit 2018<sup>1</sup>.

Kosova si shtet i ri dhe si entitet me rrugë të qartë në familjen europiane, rrugëtimin e zhvillimit të balancuar rajonal e fillon në dhjetë vjeçarim e parë të pasluftës së vitit 1999 nën udhëheqjen e zyrës së Bashkimit Europian në Kosovë. Përkatësisht fillet e politikave rajonale (zhvillimi ekonomik-shoqëror dhe i balancuar) njihen me rastin e themelimit të pesë (5) Agjencioneve për Zhvillim Rajonal. Më saktësisht zhvillimi rajonal në kontekstin e politikave të BE-së fillon në vitin 2008 kur edhe me mbështetjen e fondeve (Instrumenti për Ndihmë Para Anëtarësimit) IPA të BE-së themelohen pesë (5) Agjencionet Zhvillimore Rajonale (AZHR “Qendër”, AZHR “Veri”, AZHR “Perëndim”, AZHR “Jug” dhe AZHR “Lindje”). Agjencionet zhvillimore themelohen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës së BE-së në Prishtinë përmes marrëveshjeve ndërkomunale. Përveç IPA, me rëndësi në aspektin e

---

<sup>1</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/1E2A13A2-A0AD-4C22-A6F5-B35A8A3AFB32.pdf>

zhvillimit rajonal të balancuar dhe harmonizimit me politikave të BE-së janë edhe resurset nën mekanizmin e politikave të kohezionit të BE-së, përkatësisht sigurimi i lidhjes zhvillimit të balancuar të rajoneve zhvillimore, si dhe fondet tjera strukturore të BE-së. Më tepër informata lidhur me kontekstin e rajoneve zhvillimore dhe historikun gjeni në uebfaqen e MZHR, në dokumentin *PROFILET E RAJONEVE ZHVILLIMORE NË KOSOVË*<sup>2</sup>.

Kornizë të veçantë strategjike për qasjen ndaj politikave për zhvillim rajonal të balancuar në Kosovë në pajtim me kontekstin Europian (BE) paraqet Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Europian në vitin 2015. Kjo marrëveshje stipulon edhe harmonizimin e politikave zhvillimore, ekonomike dhe sociale ku përfshihen edhe politikave për zhvillim rajonal të balancuar sipas zotimit të R. Kosovës. Në kontekst të marrëveshjes, BE përcakton ndihmën për Kosovë për zbatimin e marrëveshjes dhe arritjes së objektivave në vlerë prej € 645.5 milion për periudhën 2014 – 2020<sup>3</sup>. Poashtu relevante janë nenet 75 dhe 119. Neni 75 i MSA paragrafi 7 (b), përcakton përgjegjësinë për llogaritjen dhe raportimin e BVP për kokë banore në nivel të rajonit NUTS 2, si dhe shqyrtimin e përbashkët me Komisionin e BE-së të rajoneve zhvillimore për përcaktimin e nivelit të ndihmës së nevojshme për alokim. Kurse neni 119 përcakton se palët do të identifikojnë masat për fuqizimin e bashkëpunimit për zhvillim rajonal dhe lokal për ti kontribuar zhvillimit ekonomik dhe **uljes së pabarazive rajonale**, me theks të veçantë për bashkëpunimin ndërkuftar, ndërkombëtar dhe ndër rajonal. Bashkëpunimi do të marrë parasysh fushat e përcaktuara si prioritare sipas dokumentacionit të BE-së (Acquis) në domenin e zhvillimit rajonal.

Poashtu si shtet aspirues për integrim në BE në aspektin e politikave dhe institucioneve, fusha e zhvillimit rajonal të balancuar ka për reference si dhe obligim harmonizimin me Acquis Communautaire (tërësinë e instrumenteve rregulluese) të BE-së, përkatësisht kapitullin 22 – politikave rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore. Acquis nën këtë kapitull përbëhet kryesisht nga rregulloret kuadër dhe ato të implementimit, të cilat nuk kërkojnë transpozim në legjislacionin kombëtar. Ato përcaktojnë rregullat për hartimin, aprovimin dhe zbatimin e Fondeve Strukturore dhe programeve të Fondit të Kohezionit që pasqyrojnë organizimin territorial të secilit vend. Zbatimi i këtyre programeve është përgjegjësi e shteteve anëtare të cilat duhet të respektojnë në përgjithësi legjislacionin e BE-së si në fushën e prokurimit publik, konkurrencës dhe mjedisit sa herë që përzgjedhin dhe zbatojnë projektet. Gjithashtu domosdoshmëria e kornizës institucionale dhe kapacitetet adekuate administrative për të siguruar se programimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi mund të zhvillohen arsyeshëm dhe janë eficientë kur konsiderohen nga perspektiva e menaxhimit dhe kontrollit financiar janë pika kyce të pasqyruara në Kapitullin 22.

Politikave Rajonale të BE-së janë zhvilluar me qëllim që të **redukojnë pabarazitë socio-ekonomike** mes shteteve anëtare dhe mes rajoneve brenda të njëjtit vend dhe të **sigurojnë integrim socio-ekonomik dhe kohezion**. Nga ana tjetër koordinimi i instrumenteve strukturore kërkon krijimin e strukturave institucionale dhe administrative, si dhe zbatimin e rregulloreve të përgjithshme dhe specifike që lidhen me çdo **Fond Struktural** dhe me **Fondin e Kohezionit**, të cilët përbëjnë instrumentet financiare të BE-së për arritjen e objektivave të përcaktuara të politikave.

---

<sup>2</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/E117C745-B8ED-4866-BB5F-86996C0BE946.pdf>

<sup>3</sup> <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/>

## Rajonet Zhvillimore

Sistemi i qeverisjes në Kosovë është i organizuar në dy nivele qendror dhe lokal dhe për këtë arsye termi rajon zhvillimor nënkupton grupimin e komunave për qëllime të planifikimit dhe zbatimit të politikave për zhvillim socio-ekonomik dhe në asnjë mënyrë nuk nënkuptohet organizimi i instancave administrative në nivel rajonal apo instancë qeverisjeje. Për më tepër rajonet zhvillimore janë themeluar në bazë të marrëveshjes për bashkëpunim ndër-komunal, dhe kështu rajoni zhvillimor i referohet autoriteteve lokale dhe dispozitave ligjore nga ligji për vetëqeverisje lokale. Më saktësisht, Agjencionet për Zhvillim Rajonal (5) sipas statutit janë organizata jo-qeveritare (OJQ) të themeluara nga autoritetet komunale. Më saktësisht, qasja e zhvillimit rajonal në Kosovë njihet që më herët, por në aspekt të shfrytëzimit më strukturor të fondeve të BE-së njihet që nga viti 2008 përmes themelimit të pesë (5) agjencioneve zhvillimore rajonale (AZHR “Qendër”, AZHR “Veri”, AZHR “Perëndim”, AZHR “Jug” dhe AZHR “Lindje”). Për qëllim të zbatimit të politikave për zhvillim socio-ekonomik, komunat në Kosovë janë organizuar në pesë (5) rajone zhvillimore (në kohën e qeverisjes nga UNMIK-u), kurse me ligjin për zhvillim rajonal i cili është miratuar në Qeverinë e Kosovës (Dhjetor 2022) parashihen organizimi në shtatë (7) rajone zhvillimore duke marrë parasysh ndarjen e Kosovës në rajone statistikore sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe në pajtim me EUROSTAT-in. Agjencia e Statistikave e Kosovës ka përgatitë dokumentin KLASIFIKIMI I RAJONEVE STATISTIKORE NË KOSOVË në shtator të vitit 2021, si propozim i bazuar në rregulloren EN (KE) NR. 1059/2003, ku paraqitet propozimi i organizimit në shtatë (7) rajone statistikore në pajtim me kriteret NUTS 3 dokument i cili është aprovuar nga Eurostat.

Ky raport për kontekst ka organizimin e rajoneve zhvillimore në pesë (5) rajone zhvillimore. Referuar në dokumentin Profili i Rajoneve Zhvillimore<sup>4</sup> tabela më poshtë paraqet në formë të përmbledhur të dhëna themelore për pesë (5) rajonet. Për më tepër

	<b>Emërtimi i rajonit zhvillimor</b>	<b>Sipërfaqja km<sup>2</sup></b>	<b>Numri i komunave</b>	<b>Numri i banorëve</b>
<b>1</b>	RZH Qendër	2,215.52	8	511,562
<b>2</b>	RZH Lindje	2,298.50	11	327,960
<b>3</b>	RZH Veri	2,051.84	7	225,938
<b>4</b>	RZH Perëndim	2,324.38	6	323,588
<b>5</b>	RZH Jug	2,015.01	6	409,449
	Gjithësej	10,905.25	38	1,798,497.00

Nga karakteristikat e territorit dhe elementeve përbërëse mund të shihet se grupimi i komunave në rajone zhvillimore pasqyron afërsinë gjeografike dhe kohezionin ekonomik dhe social, dmth ndërveprimin e shoqërisë dhe ekonomisë në mes të komunave të cilat i takojnë një rajoni përkatës zhvillimor. Poashtu pasqyrohet qasja gjatë organizimit të rajoneve zhvillimore në balancimin e aspektit territorial dhe demografik, pasi që në masë të madhe rajonet zhvillimore grupojnë komuna duke formuar sipërfaqe të krahasueshme territoriale, ndonëse me karakteristika të ndryshme të reliefit (tokë punë, kodrinore, malore) e poashtu edhe në aspektin e popullsisë shihet një balancim sa i përket numri të banorëve sipas rajoneve zhvillimore (regjistrimit 2011 ASK) ndonëse në vitin kur është duke u pregatitur kjo analizë aspekti

<sup>4</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/E117C745-B8ED-4866-BB5F-86996C0BE946.pdf>

demografik mund të jetë shumë më i ndryshuar marrë parasysh ndryshimet në transformimin e strukturës demografike në mes të viteve 2011 – 2022.

### **Dokumentet strategjike dhe aktet ligjore**

Aktet mbi politikat, strategjitë, planet e veprimit dhe instrumentet ligjore (ligjet dhe aktet nënligjore) mbi të cilat është ngritur dhe e zbaton mandatin MZHR-ja në realizimin e misionit për Avancimin e Zhvillimit Rajonal të balancuar janë:

- Koncept dokumenti i vitit 2018, [Koncept Dokument – Zhvillimi Rajonal në Kosovë, Korrik 2018];
- Strategjia për Zhvillim Rajonal e vitit 2020, [Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020 – 2030];
- Projektligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar i vitit 2022 (PLZHRB i aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Dhjetor 2022). Ky projektligj pritet të aprovohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës në K2 të v.2023;
- Ligji për bashkëpunim ndër-komunal, [Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal];
- Ligji për qeverisje lokale, [Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale];
- Ligji për investimet e huaja strategjike në Kosovë, [Ligji nr. 05/L-079 për Investime strategjike ne Republikën e Kosovës];
- Ligji për investimet e huaja në Kosovë, [Ligji nr. 02/L-33 për Investimet e Huaja];
- Ligji për themelimin e zonave të lira ekonomike në Kosovë, [Ligji nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike];
- Ligji i përgjithshëm për sektorin e turizmit në Kosovë, [Ligji nr. 04/L-176 për Turizmin];
- Ligji i përgjithshëm për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë, [Ligji nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillim Rural].

Themelimi dhe funksionimi i Ministrisë për Zhvillim Rajonal aktualisht mbështetet në Rregulloren Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, e cila përcakton mandatin e MZHR-së. Përkatësisht janë këto akte nënligjore, kjo në mungesë të ligjit sistemor i cili është në proces e sipër:

- Rregullore Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive;
- Rregullore Nr. 07/2011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive;
- Rregullore (QRK) Nr.14/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e Ndryshuar e Plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2011;
- Rregullore (QRK) Nr. 15/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e Ndryshuar e Plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2011 dhe Rregulloren Nr. 14/2017;
- Rregullore (QRK) - Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive;



- Rregullore (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive;
- Rregullore (QRK) - Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive;
- Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022,
- Përmbledhja e Udhëzuesve të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal:
  - Udhëzuesi për ciklin e procedurave të prokurimit;
  - Udhëzuesi për menaxhimin dhe ekzekutimin e projekteve në kategorinë Investime Kapitale;
  - Udhëzuesi për menaxhimin dhe ekzekutimin e projekteve për subvencione (grante për biznese dhe OSHC-të);
  - Udhëzuesi i procedurës së ekzekutimit të pagesës për kategorinë ekonomike mallra dhe shërbimeve dhe kategorinë shpenzime komunale;
  - Udhëzim Administrativ (MZHR) - Nr. 01/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MZHR) – Nr. 01/2018 i Ndryshuar dhe Plotësuar ee Udhëzimin Administrativ Nr. 02.2018 për Kushtet dhe Kriteret e Përkrahjes së Bizneseve/Ndërmarrësve të Rinj nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balansuar.

## **Koncept dokumenti**

Fillet e qasjes së organizuar në nivelin qendror institucional lidhur me Rajonet Zhvillimore në Kosovë paraqiten në koncept dokumentin e vitit 2018, kurse shtytja nga ana e EU përmes projekteve të Komisionit European në Kosove e njeh dhe e mbështet qasjen e zhvillimit ekonomik dhe social përmes qasjes rajonale zhvillimore prej vitit 2008 përmes krijimit të Agjencioneve për Zhvillim Rajonal (AZHR) në pesë (5) rajone në Kosovë.

Koncept dokumenti në kontekst të vendosjes së qëllimeve dhe objektivave zhvillimore, bën edhe definimin e problemit:

1. Pabarazi rajonale nga aspekti i indikatorëve socio-ekonomik;
2. Mungesë të politikave zhvillimore për nxitjen e konkurrencës më të madhe në rajon;
3. Mos ndërlidhja në mes të politikave sektoriale zhvillimore të qeverisë dhe aktiviteteve në nivele të rajoneve;
4. Mungesë të stimulimit të bashkëpunimit ndërajonal, ndërkufitar, dhe ndërkombëtare;
5. Mos klasifikimi i Kosovës sipas rajoneve statistikore NUTS;
6. Mungesë të mekanizmve të nevojshëm për qasje në fondet zhvillimore të BE-së dhe në menaxhim të rajonit në përgjithësi.

Nga problemet e identifikuar theks të vecantë përbën edhe mungesa e kornizës ligjore specifike për zhvillim të balancuar socio – ekonomik, mungesa e koordinimit të aktiviteteve dhe politikave ndërsektoriale në nivel qendror lidhur me zhvillim të balancuar ekonomik dhe social të rajoneve, mungesa e hamonizimit të njësive territoriale sipas nomenklaturës së BE (klasifikimi sipas NUTS), e rrjedhimisht edhe mungesa e mekanizmit për sigurimin e qasjes në fonde të BE për zhvillim rajonal (IPA, Fond i BE për Zhvillim të Rajoneve ERDF, Fondi i Kohezionit). Lista me probleme të identifikuar është më e gjatë, kurse këto të cekura më lartë paraqiten si prioritet duke ju referuar vitit bazë kur edhe është themeluar Ministria e Zhvillimit Rajonal 2017, ndonëse me operim fillon prej vitit 2018. Në mungesë të ligjit specifik MZHR

ka zhvilluar aktivitete për promovimin dhe mbështetjen për zhvillim të balancuar rajonal duke ju referuar ligjeve si ai për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal, e poashtu edhe duke u referuar në një sërë aktesh nënligjore.

Objektivat specifike të formuluar në koncept dokumentin janë:

1. Zvogëlimi i pabarazive të mundshme rajonale, posacërisht duke stimuluar zhvillimin e balancuar dhe revitalizimin e zonave të margjinalizuara (që kanë ngecje në zhvillim);
2. Rritja e konkurrencës së rajoneve nëpërmjet forcimit të kapacitetit të tyre për inovacione, shfrytëzimit optimal dhe valorizimi i pasurisë natyrore, kapitalit njerëzor dhe vecorive ekonomike të rajoneve të ndryshme;
3. Ndërlidhja me politika sektoriale zhvillimore të qeverisë dhe aktiviteteve në nivele të rajoneve duke stimuluar bashkëpunimin ndër rajonal, ndërkombëtar dhe ndërkufitar që ndikon në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenie të popullatës;
4. Përgatitja e kornizës institucionale për të përmbushur kërkesat integruese në Strukturat e BE-së si dhe të sigurohet qasja në instrumentet e asistencës financare (IPA II, Fondet strukturale dhe të investimeve të BE-së).

Nga opcionet e paraqitura si model për avancimin e zhvillimit rajonal në kuadër të konceptit, përzgjedhet opsioni II, i cili ka për bazë krijimin e mekanizimit (Ministrinë për Zhvillim Rajonal) përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillim rajonal të balancuar, koordinimin e politikave sektoriale me ministritë e tjera si dhe me aktivitetet e donatorëve në fushën e zhvillimit, përkatësisht opsioni për organizimin e rajoneve në kuptimin e politikave për zhvillim social dhe ekonomik sipas NUTS 3. Në kuadër të këtij opsioni, parashihet hartimi i strategjisë për zhvillim rajonal si dhe aprovimi i ligjit për zhvillim rajonal të balancuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

### **Strategjia për Zhvillim Rajonal (2020 – 2030)**

Qëllimi i përgjithshëm is strategjisë është që të sigurojë harmonizimin me sektorët tjerë të qeverisë me strategjinë kombëtare për zhvillim dhe strategjitë specifike sektoriale. Strategjia përkufizon tre (3) synime të përgjithshme duke i deklaruar si boshte strategjike të zhvillimit rajonal të balancuar në Kosovë dhe ato janë:

1. Mbështetja e rritjes konkurruese të rajoneve;
2. Themelimi i kohezionit territorial dhe parandalimi i proceseve të margjinalizimit të zonave problematike;
3. Vendosja e kushteve për zbatimin efektiv dhe partneritetit të aktiviteteve zhvillimore të synuara në rajonet socio-ekonomike.

Plani strategjik është zhvilluar për të mbuluar një horizont kohor 10 vjeçar nga viti 2020 deri në vitin 2030, ku MZHR përmes grupit punues ndërministror ka përfshirë të gjitha instancat relevante (ministritë kanë pësuar ndryshime në emërtime dhe kompozim gjatë periudhës 2017-21, ky emërtim i refereohet periudhës kur është hartuar SZHR 2020-30) në përgatitjen e strategjisë e poashtu ka konsultuar edhe shoqërinë civile. Institucionet publike pjesë të grupit punues të udhëhequr nga MZHR-ja janë:

- Ministria e Zhvillimit Rajonal
- Ministria e Pushtetit Lokal
- Zyra e Kryeministrit
- Zyra për Planifikim Strategjik
- Zyra e Integritimit Evropian/ ZKM
- Ministria e Financave
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës

- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Ministria e Infrastrukturës
- Agjencia e Statistikave të Kosovës

Nga sektori i shoqërisë civile në grup punues janë përfshirë, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe pesë (5) Agjencionet për Zhvillim Rajonal (AZHR-të).

Strategjia paraqet analizën socio-ekonomike të secilit prej pesë (5) rajoneve zhvillimore të organizuara jo-formalisht në nivel NUTS 3 duke shfrytëzuar ndarjen sipas aranzhimeve të MAPL-së dhe Zyrës së BE-së në Kosovë të vitit 2008. Në analizën socio-ekonomike përshkruhen karakteristikat gjeografike (territori, popullsia) politike dhe administrative të regjionit (komunat) si dhe niveli i zhvillimit ekonomik dhe social (arsimimi).

Në përshkrimin e nivelit dhe strukturës së ekonomisë pasqyrohet numri i bizneseve dhe struktura e ekonomisë, shkalla e punësimit (papunësia). Poashtu pasqyrohen edhe kapacitetet infrastrukturore dhe lidhjet që ofrohen mbrenda rajonit, mes rajoneve si dhe mes rajoneve në kuptimin e bashkëpunimit ndërkuftar dhe ndër shtetëror. Paraqiten edhe aspektet e potencialit ekonomik, resurset dhe potencialet për zhvillim. Në këtë kontekst, strategjia vijon në përcaktimin e objektivave duke siguruar koordinimin dhe harmonizimin me politikat e tjera ndër-institucionale (Strategjia për zhvillim ekonomik, Strategjitë për Arsim, Turizëm, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, etj.). Ndonëse parametrat kyç matja sipas treguesve të standardizuar të shkallës së zhvillimit ekonomik, **BPV për kokë banori për rajon zhvillimor nuk është dhënë sepse këtë të dhënë ASK e gjeneron në nivel nacional**. Kjo për shkak se ende nuk llogaritet ky tregues nga ana e Agjencisë së Statistikave të Kosovës apo edhe nga ana e Ministrisë së Financave.

Problemet dhe mungesa e faktorëve nxitës të identifikuar për zhvillim rajonal të balancuar në strategji janë:

1. Mungesa e sistemit për matjen e performancës rajonale sipas rajoneve zhvillimore;
2. Mungesë të politikave zhvillimore për të nxitë konkurrencë më të madhe në rajon;
3. Mos ndërlidhja në mes të politikave sektoriale zhvillimore të qeverisë dhe aktiviteteve në rajone zhvillimore;
4. Qasje e kufizuar në programe të bashkëpunimit rajonal;
5. Mos klasifikimi i Kosovës sipas rajoneve statistikore NUTS;
6. Mungesë të mekanizmave të nevojshme për bashkërendimin të zhvillimit rajonal.

Gjatë përcaktimit të objektivave strategjia shqyrton rastet nga shtetet e rajonit me qëllim të studimit krahasues për identifikimin e modeleve të përshtatshme dhe të zbatueshme në Kosovë.

## Objektivat strategjike dhe objektivat specifike

Objektivat strategjike	1.Koordinimi i politikave të zhvillimit rajonal	2.Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale	3.Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane
<b>Objektivi specifik 1</b>	Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar	Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në bazë të vlerësimeve	Resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane të qëndrueshme dhe të promovuara
<b>Objektivi specifik 2</b>	Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale	Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik	Ndërtimi i kapaciteteve humane dhe të OSHC-ve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik rajonal
<b>Objektivi specifik 3</b>		Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar	Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar
<b>Objektivi specifik 4</b>		Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal përmes programeve transnacionale	

Plani i veprimit i zhvilluar me qëllim të mobilizimit të resurseve për zbatim të strategjisë është i organizuar për një periudhë kohore prej tre (3) vitesh prej vitit 2020 deri në vitin 2023. Plani i veprimit pasqyron aktivitetet dhe indikatorët si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktivitetit apo aktiviteteve të parapara në kuadër të objektivit specifik. Ku përmbushja e objektivave specifike sipas planit kohor nënkupton përmbushjen e objektivit përkatës strategjik dhe kështu nënkupton realizimin e strategjisë. Plani i veprimit të Strategjisë rishikohet në baza vjetore në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në strategji ku përmes treguesve dhe vlerave të paracaktuara (targetit) për indikatorë maten arritjet në realizimin e aktiviteteve dhe kështu informohet përmbushja e pjesëzave të strategjisë.

### **Projektligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar**

Përgatitja e Projektligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar është kërkesë e cila buron në MSA si pjesë e Aquis Communautaire me qëllim të sigurimit të kornizës ligjore dhe institucionale për zbatimin e politikave të kohezionit dhe sigurimin e fondeve strukturore të BE-së. Poashtu kjo paraqet edhe orientim politik të deklaruar në Kosovë lidhur me synimet integruese në BE.

Ndryshim esencial paraqitet organizimi i ri i rajoneve zhvillimore i cili bazohet në organizimin e zhvilluar nga Agjencioni i Statistikave i Kosovës i cili e organizon Kosovën në shtatë (7) rajone statistikore. Deri në miratimin e projektligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar Ministria e Zhvillimit Rajonal ka operu dhe operon me pesë (5) rajone zhvillimore.

Në dhjetor të v.2022 Ministria e Zhvillimit Rajonal ka aprovuar në Qeveri projektligjin për zhvillim rajonal të balancuar i gatshëm për aprovim në Kuvendin e Kosovës. Projektligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar përvec fushëveprimit përmbanë dispozitat për nocionin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar si dhe mandatin e MZHR-së. Poashtu përmban

kriteret e vlerësimit për zhvillim të balancuar rajonal, politikat dhe dokumentet e zhvillimit rajonal – planifikimi (niveli nacional strategjik, programet, dhe planet operationale) që nënkupton kornizen planifikuese afatgjate dhe planet zbatuese afatshkurtëra. Ligji parasheh burimet dhe strukturat e financimit të zbatimit të Planeve Operationale, Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar mekanizmat implementues të programit dhe politikave për zhvillim të balancuar rajonal. Projekt-ligji themelon shtatë (7) Qendrat për Zhvillim Rajonal. MZHR do të koordinohet me komunat për themelimin e qendrave për zhvillim rajonal përmes marrëveshjes ndërkomunale dhe MZHR me akt nënligjor do të rregulloj themelimin, organizimin, funksionimin dhe monitorimin e qendrave për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore, të cilat planifikohet të kenë një strukturë të ngjajshme me modelet e funksionimit të qendrave në vendet e rajonit dhe vendet e BE-së. Me rastin e miratimit të ligjit, MZHR obligohet edhe për përgatitjen e një tërësie të legjislacionit sekondar (Udhëzime Administrative dhe akteve tjera) përmes të cilave fillon jetësimi i ligjit dhe ngritja e mekanizmave të paraparë institucional.

### **Korniza e akteve, mekanizmave dhe veprimeve**

Në tabelën më poshtë paraqitet korniza e niveleve dhe akteve rregulluese e paraqitur në formë të shtresave (prej EU, niveli kombëtar, deri tek dokumentet planifikuese dhe programet zbatuese), si dhe në shtylla paraqiten vijat e qëllimeve prej nivelit më të lartë politik (EU, më pas në nivelin e politikave kombëtare rregullues dhe më pas nivelet e konceptit dhe planifikimit strategjik (përkatësisht objektivat strategjike).

Nga korniza mund të shihet dhe analizohet veprimtaria e MZHR-së kundrejt mandatit në sigurimin e zbatimit të obligimeve nga MSA dhe obligimet e përgjithshme lidhur me sigurimin e zhvillimit të balancuar rajonal (zbatimi i politikave të kohezionit dhe fondeve strukturore të BE).

Në nivelin më të ulët ku specifikohen programet dhe arritjet e MZHR është krejtësisht lehtë e kuptueshme se si ndërlidhen aktivitetet e MZHR me politikat madhore (ombrellë) të BE dhe ndërlidhjes së BE me Qeverinë e Kosovës përmes MSA.

Niveli EU	Aktet (dokumente politike, koncepte, strategji, dhe ligje)	Shtyllat e politikave, dhe bashkerenditja e pikave te MSA me koncept dokumentin e MZHR, Strategjine dhe Planin e Veprimit [objektivat], si dhe instrumentet zbatuese te politikave te MZHR sipas hierarkise se dokumenteve politike, konceptuale, strategjike, dhe zbatuese			
	Aquis Communautaire - Kapitulli 22				
	MSA (Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim)				
	MSA e nënshkruar Tetor-2015	MSA/Neni 75 i MSA paragrafi 7 (b), përcakton përgjegjësinë për llogaritjen dhe raportimin e BVP për kokë banore në nivel të rajonit NUTS 2. <b>..shqyrtimin e përbashkët me Komisionin e BE-së të rajoneve zhvillimore për përcaktimin e nivelit të ndihmës së nevojshme</b>	MSA/Neni 119 - Zhvillimi ekonomik dhe ulja e pabarazive rajonale... për ti <b>kontribuar zhvillimit ekonomik</b>	MSA/Neni 119 - Zhvillimi ekonomik....Me theks të veçantë për <b>bashkëpunimin ndërkufitar, ndërkombëtar, dhe ndër rajonal.</b>	MSA/Neni 119 - Zhvillimi ekonomik dhe <b>ulja e pabarazive rajonale</b>
Niveli R. Kosoves - MZHR	Shtyllat dhe vijat programore të aktiviteteve MZHR	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
	Koncept Dokumenti i miratuar Gusht - 2018	Përgatitja e <b>kornizës institucionale</b> për të përmbushur kërkesat integruese në Strukturat e BE-së si dhe të <b>sigurohet qasja në instrumentet e asistencës financiare</b> (IPA II, Fondet strukturale dhe të investimeve të BE-së)	<b>Rritja e konkurrencës së rajoneve</b> nëpërmjet forcimit të kapacitetit të tyre për inovacione, shfrytëzimit optimal dhe valorizimi i pasurisë natyrore, kapitalit njerëzor dhe vecorive ekonomike të rajoneve të ndryshme	<b>Ndërlidhja me politika sektoriale zhvillimore të qeverisë</b> dhe aktiviteteve në nivele të rajoneve duke stimuluar bashkëpunimin ndër rajonal, ndërkombëtar dhe ndërkufitar që ndikon në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien të popullatës	<b>Zvogëlimi i pabarazive të mundshme rajonale,</b> posacërisht duke stimuluar zhvillimin e balancuar dhe revitalizimin e zonave të marginalizuara (që kanë ngecje në zhvillim)
	Plani Strategjik 2020-2030 dhe Plani Veprimit publikuar Mars - 2021	Objektivi Strategjik: 1. Koordinimi i politikave të zhvillimit rajonal	Objektivi Strategjik: 3. Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane	Objektivi Strategjik: 1. Koordinimi i politikave të zhvillimit rajonal	Objektivi Strategjik: 2. Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër-rajonale
		Objektivi specifik 1.1 Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar qe rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar.	Objektivi specifik 3.1 Resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane të qëndrueshme dhe të promovuara.	Objektivi specifik 2.4 Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal përmes programeve trans nacionale	Objektivi specifik 2.1 Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në bazë të vlerësimeve
		Objektivi specifik 1.2 Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.	Objektivi specifik 3.2 Ndërtimi i kapaciteteve humane dhe të OSHC-ve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik rajonal	Objektivi specifik 2.3 Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar	Objektivi specifik 2.2 Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik
	Objektivi specifik 3.3 Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar				
Instrumentet e zbatimit	Programet dhe arritjet e MZHR	Draft i ligjit per Zhvillim Rajonal	PZHRB	Programi mbeshtetje per OSHC	PZHR
	Pasqyrim i gjendjes Mars - 2022	Studimi i fizibilitetit per sistemin e monitorimit te performances	Programi mbeshtetje per OSHC		PZHRB

## Analizat Socio-ekonomike

Analizat socio-ekonomike sipas kërkesave të Eurostatit për nivelin NUTS 3 bazohen në një tërësi treguesish (indikatore) të cilët nuk kanë qenë në dispozicion në vitet e kaluara por të cilët pritet që të sigurohen nga Agjencioni i Statistikave i Kosovës për vitet në vijim (bazuar në shkëmbimet e grupit punues të MZHR-së). Këta tregues, kryesisht të fushës së makroekonomisë, punësimit dhe produktivitetit, standardit të jetesës, arsimit, mjedisit, energjisë, etj, ndonëse janë në dispozicion në nivel të Kosovës, në nivel të rajoneve zhvillimore për nevojat e analizës socio-ekonomike në kontekst të mandatit të MZHR janë në proces të përgatitjes. MZHR poashtu ka ndërmarrë aktivitete për formulimin e treguesve dhe të sistemit të mbledhjes dhe analizës së treguesve socio-ekonomik. Shih. Dokumentin "Studimi dhe dizajnimi i sistemit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar"<sup>5</sup>

Në mungesë të parametrave specifik rajonal për matjen e shkallës së zhvillimit social dhe ekonomik, MZHR si parametër për krahasim të ndarjeve ka shfrytëzuar numrin e banorëve sipas regjistrimit të vitit 2011, si dhe numrin e bizneseve. Parametra të tjerë për regjione janë marrë nga përshkrimi i regjioneve, si institucionet edukative, struktura e popullsisë, punësimi, bizneset, sipërfaqet bujqësore dhe pyjore, etj. Përkatësisht popullsia e rajoneve zhvillimore apo komunave përbërëse janë agreguar për të pasqyruar kontekstin, e më pas edhe llogaritjet mbi shëprndarjen e investimeve.

Ndonëse në mungesë të të dhënave specifike për matjen e zhvillimit socio-ekonomik prej themelimit MZHR në kuadër të zbatimit të mandatit zhvillon analiza socio-ekonomike të rregullta vjetore me qëllim të pasqyrimin të zhvillimeve në rajonet zhvillimore përkatëse. Më saktësisht, në baza vjetore përgatit dhe publikon analizat mbi zhvillimet socio-ekonomike të rajoneve zhvillimore ku analizohen programet zhvillimore të MZHR-së si PZHR (Programi për Zhvillim Rajonal) dhe PZHRB (Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar), si the investimet kapitale të ministrive (sipas linjave) dhe sipas rajoneve zhvillimore, si dhe aktivitetet e financuara nga autoritetet komunale. Raportet analitike të përgatitura nga MZHR janë vjetore dhe shumë vjeçare (si studime periodike).

Me interes për nën kapitullin Analiza socio-ekonomike janë raportet:

- Analizë e zhvillimit Socio – Ekonomik rajonal të balancuar në v.2021;
- Analizë e zhvillimit Socio – Ekonomik rajonal të balancuar, periudha 2018-2020<sup>6</sup>;
- Analizë e zhvillimit Socio – Ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë – viti 2019<sup>7</sup>;
- Analizë e zhvillimit Socio – Ekonomik rajonal të balancuar në vitin 2018<sup>8</sup>;
- Analiza e investimeve kapitale për periudhën në v.2021;
- Analiza e investimeve kapitale për periudhën 2018-2020<sup>9</sup>;
- Analizë e investimeve kapitale të realizuara sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë – viti 2019<sup>10</sup>;
- Analizë e investimeve kapitale të Ministrive të linjës në rajonet zhvillimore në Kosovë – viti 2018<sup>11</sup>;

<sup>5</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/7AE044FF-4743-4E32-AB90-9A6AD6103D7E.pdf>

<sup>6</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/A92C1B58-70E4-4405-BC30-EE878E7829F9.pdf>

<sup>7</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/FC1638EF-76C3-48CC-AEDF-B56734467902.pdf>

<sup>8</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/342457EF-AD19-465F-9748-83FF41A2064E.pdf>

<sup>9</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/A92C1B58-70E4-4405-BC30-EE878E7829F9.pdf>

<sup>10</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/20A91676-F721-4A7A-89D0-B21A5DA802AF.pdf>

<sup>11</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/286DB1FB-27DF-4306-BA65-7DF87A3E39E9.pdf>

- Analizë mbi funksionimin e Zonave Ekonomike v.2021<sup>12</sup>;
- Dokumenti shpjegues për hartimin e kritereve për brendimin e rajoneve zhvillimore v.2021<sup>13</sup>;
- Pasqyrimi i inventarizimit kulturor sipas rajoneve zhvillimore v.2021<sup>14</sup>.

Ndërkaq për pasqyrim të plotë të aktiviteteve të MZHR dhe avancimit të zhvillimit socio-ekonomik të balancuar poashtu duhet të shqyrtohen edhe raportet vjetore të MZHR-së.

Përkatësisht, analiza e zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve zhvillimore kuptohet si vlerësim apo analizë e kategorive të veçanta apo segmenteve sociale dhe institucionale në raport me programet e hartuara dhe zbatuara nga MZHR. Prandaj edhe analizat socio-ekonomike i referohen vlerësimit të arritjeve në fushat e intervenimit, duke vlerësuar:

- Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar (ku objektivi i intervenimit është zhvillimi i sektorit privat me qëllim të rritjes së ekonomisë dhe krijimit të vendeve të punës).
- Programi për Zhvillim Rajonal (ku objektivi i analizës janë investimet kapitale apo krahasimi i alokimit të investimeve në nivel të komunave sipas rajoneve zhvillimore, duke analizuar investimet dhe arritjet e investimeve sipas ministrive të linjave, si dhe investimet e zhvilluara nga vet autoritetet e qeverisjes lokale - komunave).

Nga raporti Analiza e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar 2018 – 2020, kuptohet se MZHR për katër (4) vite (2018 - 2021) përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka mbështetur sektorin privat në vlerë totale prej 7,007,362 €, duke ia shtuar dy masat për rimëkëmbje ekonomike Masa 8 e implementuar në vitin 2020 dhe Masa 15 e implemtuar në v.2021. Kjo analizë gjithashtu trajton programet – skemat për dhënien e granteve të implementuara edhe nga Ministrinë e linjës si të dhënat krahasimore të vitit 2020 dhe vitit 2019 të skemës së granteve për përkrahje të ndërmarrejeve të vogla dhe të mesme (NMV-ve), program i implementuar edhe Agjencia për Investime dhe përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe përkrahjen e sektorit privat nga Ministria e Inovacionit për v.2019. Gjithashtu në v.2021<sup>15</sup> në kuadër të kësaj analize është përfshirë edhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me programin e saj të granteve për bujq. Financimi i programit sipas rajoneve zhvillimore prej periudhes 2018-2021 pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

	Emërtimi i rajonit zhvillimor	Buxheti 2018 EUR	Buxheti 2019 EUR	Buxheti 2020 EUR	Buxheti 2021 EUR	Buxheti total EUR (2018-2021)	Numri i bizneseve mbështetura	Të punësuar (persona)
1	RZHQ	277,211	518,406	416,517	295,183	1,507,317	138	514
2	RZHJ	304,349	475,781	402,951	273,259	1,456,340	133	448
3	RZHP	303,163	460,775	383,588	301,200	1,448,726	138	427
4	RZHV	208,112	449,517	375,613	233,940	1,267,182	121	352
5	RZHL	253,969	483,289	317,844	272,695	1,327,797	130	375
6	<b>Gjithsej</b>	<b>1,346,804</b>	<b>2,387,768</b>	<b>1,896,513</b>	<b>1,376,277</b>	<b>7,007,362</b>	<b>660</b>	<b>2116</b>

<sup>12</sup> [A64F86A1-E70E-4946-B88B-833DCFFA9CC0.pdf \(rks-gov.net\)](#)

<sup>13</sup> [7DF1223F-423E-4380-BEE5-614977121AD1.pdf \(rks-gov.net\)](#)

<sup>14</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/28BA7EB5-4792-402E-8650-E84FDAF2B026.pdf>

<sup>15</sup> [ANALIZË E ZHVILLIMIT SOCIO – EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR NË KOSOVË - VITI 2021 \(rks-gov.net\)](#)



Në tabelë vërehet qasje e balancuar në alokimin e buxheteve për aktivitetet e zhvillimit socio-ekonomit të programit PZHRB nga ana e MZHR-së kur krahasohen financimet në mes të rajoneve zhvillimore dhe specifikat e rajoneve. Raporti poashtu analizon edhe shpërndarjet sipas komunave – brenda rajoneve si dhe kategorive të përkatësisë etnike të përfituesve, gjinisë, sektoreve, si dhe lot-eve specifike tre (3) lot-e specifike – kategorizimi i përfituesve të synuar.

Nga raporti Analiza e Investimeve Kapitale për periudhën 2018-2021 pasqyrohet shpërndarja e mjeteve buxhetore për qëllim të investimeve kapitale të zbatuara nga Ministritë e Linjës për periudhën 2018 – 2021, sipas rajoneve zhvillimore si në nivel të komunave në kuadër të rajoneve zhvillimore. Analiza e zhvilluar në raport mundëson të kuptuarit e intervenimeve nga niveli qendror si dhe nga ai lokal (investimet e komunave me mjete vetanake), mbi shpërndarjen e mjeteve në aspektin e balancimit të zhvillimit socio-ekonomik rajonal.

Disbursimi i investimeve kapitale sipas ministrive në rajonet zhvillimore, si dhe numri i projekteve për periudhën 2018 – 2021 pasqyrohet në tabelën mëposhtë e marrë nga raporti.

Nr	Ministritë	Totali i investimeve kapitale (€)				Totali i projekteve			
		2018	2019	2020	2021	2018	2019	2020	2021
1	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	11,007,039.87	10,238,429.02	7,752,050.58	2,919,604.18	35	55	49	36
2	Ministria e Shëndetësisë	2,322,344.40	2,636,103.72	925,823.64	944,411.76	8	4	4	5
3	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	1,059,563.36	2,866,345.00	3,920,697.23	7,621,022.84	17	51	39	37
4	Ministria për Komunitete dhe Kthim	942,657.14	807,381.00	908,475.46	2,314,604.14	21	18	10	29
5	Ministria e Punëve të Brendshme	3,783,341.51	18,729,969.51	9,505,687.87	5,270,547.47	17	19	35	17
6	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	5,016,560.31	11,799,570.79	8,343,698.29	6,817,929.78	35	64	49	50
7	Ministria e Infrastrukturës	27,846,189.95	34,995,984.09	19,004,527.09	31,003,632.10	155	189	145	133
8	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	12,045,706.59	3,448,556.00	2,883,696.00	9,146,399.30	54	71	51	94
9	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	595,014.73	630,408.20	739,923.98	30,460.28	14	3	21	1
10	Ministria e bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2,141,741.16	/	/	2,078,072.31	7	/	/	6
11	Ministria e Industrisë, Ndermarrësisë dhe Tregtisë	2,007,534.58	2,442,213.69	1,594,542.28	664,279.63	3	5	4	3
12	Ministria e Zhvillimit Rajonal	1,534,754.12	2,010,550.53	2,006,559.28	854,206.24	21	29	31	16
13	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	3,513,819.89	3,475,549.34	1,993,208.11	2,343,896.24	51	56	23	49
	<b>Totali i investimeve kapitale ne Komuna/Rajone</b>	<b>73,816,267.65</b>	<b>94,081,060.89</b>	<b>59,635,862.16</b>	<b>72,009,066.27</b>	<b>438</b>	<b>564</b>	<b>469</b>	<b>476</b>

Nga pasqyra e investimeve kapitale nga Ministrinë e Linjës komunikohet një trend i vazhdueshëm i investimeve me qëllim të transformimit dhe avancimit të rajoneve në Kosovë në kuptimin e zhvillimit socio – ekonomik.

Më poshtë, nga i njejtë raport, është marrë tabela me analizën e shpërndarjes së investimeve kapitale nga ministrinë (**niveli qendror**) e disagreguar sipas rajoneve zhvillimore për vitet 2019 - 2021 si dhe duke analizuar ndarjen e investimeve për kokë banori si parametër i rëndësishëm krahasues për shpërndarjen.

<b>Investimet kapitale të Ministrive sipas rajoneve</b>						
<b>Rajonet zhvillimore</b>	<b>Vitet – Vlerat e financimit</b>				<b>Nr.i Banorëve</b>	<b>Euro/kokë banori</b>
	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>TOTALI (2019 -2021)</b>		
<b>Qendër</b>	18,532,407.78	12,009,342.81	14,757,225.40	45,298,975.99	513,350.00	<b>88.24</b>
<b>Lindje</b>	23,149,235.00	14,014,996.92	19,721,037.18	56,885,269.10	319,249.00	<b>178.18</b>
<b>Veri</b>	17,828,499.03	9,454,583.84	7,762,174.42	35,045,257.29	220,398.00	<b>159.01</b>
<b>Perëndim</b>	22,580,731.34	15,418,094.50	19,100,814.69	57,099,640.53	320,241.00	<b>178.30</b>
<b>Jug</b>	11,990,187.26	8,738,844.02	10,667,814.58	31,396,845.86	400,733.00	<b>78.35</b>
<b>Totali:</b>	<b>94,081,060.89</b>	<b>59,635,862.16</b>	<b>72,009,066.27</b>	<b>225,725,988.77</b>	<b>1,773,971.00</b>	<b>127.24</b>

Nga analiza e prezantuar në tabelën nga raporti përkatës, komunikohet qasja e investimeve kapitale në transformimin e rajoneve zhvillimore me qëllim të avansimit socio-ekonomik duke ulur kështu pabarazitë me qëllim të sigurimit të zhvillimit të balancuar.

Më saktësisht, kur krahasohen investimet për kokë banori kuptohet se rajonet zhvillimore më të avancuara kanë marrë më pak investime kapitale si RZHQ dhe RZHJ, krahasuar me tre (3) rajonet tjera të cilat janë në disavantazh sa i përket zhvillimit socio-ekonomik krahasuar me këto dy të sipërpermenduar. RZHQ dhe RZHJ kanë investime kapitale rreth 30% deri 50% më të ulëta për kokë banori krahasuar me tre rajonet e tjera. RZHQ dhe RZHJ shquhen me investime kapitale për kokë banori me rreth 78 EUR deri 88 EUR, kurse tre (3) rajonet tjera kanë përfituar investime kapitale prej 127 EUR deri 178 EUR për kokë banori.

Më poshtë, nga i njejtë raport, është marrë tabela me analizën e shpërndarjes së investimeve kapitale nga niveli i pushtetit lokal (investimet vetanake të komunave) e organizuar sipas rajoneve zhvillimore për vitet 2019 deri 2021, si dhe duke analizuar ndarjen e investimeve për kokë banori si parametër i rëndësishëm krahasues për arritje në shpërndarje. Përkatësisht, këto janë vlerat e investimeve sipas rajoneve por që janë arritur nga vet komunat.

<b>Investimet kapitale të Komunave sipas rajoneve</b>						
<b>Rajonet zhvillimore</b>	<b>Vitet – Vlerat e financimit</b>				<b>Nr. i banorëve</b>	<b>Euro / kokë banori</b>
	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>TOTALI</b>		
	<b>(2019 -2021)</b>					
<b>Qendër</b>	45,159,224.09	34,509,546.53	49,781,285.68	129,450,056.30	513,350.00	<b>252.17</b>
<b>Lindje</b>	19,536,427.85	20,160,018.73	37,473,962.02	77,170,408.60	319,249.00	<b>241.72</b>
<b>Veri</b>	12,783,671.58	12,589,560.95	19,220,754.41	44,593,986.94	220,398.00	<b>202.33</b>
<b>Perëndim</b>	17,905,068.00	19,085,707.61	37,482,924.81	74,473,700.42	320,241.00	<b>232.56</b>
<b>Jug</b>	18,854,976.01	24,837,652.13	34,935,060.24	78,627,688.38	400,733.00	<b>196.21</b>
<b>Totali:</b>	<b>114,239,367.53</b>	<b>111,182,485.95</b>	<b>178,893,987.16</b>	<b>404,315,840.64</b>	<b>1,773,971.00</b>	<b>227.92</b>

Nga analiza e investimeve kapitale të zbatuara nga vet komunat në nivel të rajoneve zhvillimore, pasqyrohet se RZHQ ka arritë nivelin më të lartë të investimeve për kokë banori 252.17 EUR dhe më pas vjen RZHL me 241.72 EUR për kokë banori. Tre (3) rajonet e tjera zhvillimore karakterizohen me shkallë më të ulët të realizimeve të investimeve kapitale nga mjetet vetanake duke rezultuar me tregues prej 196.21 EUR deri në 232.56 EUR për kokë banori shkallë kjo dukshëm më e ulët krahasuar me dy rajonet prijëse, në këtë mënyrë duke komunikuar edhe disparitetin në shkallën e zhvillimit ekonomik dhe social. Në këtë pikë ndërhyrja nga niveli qendror apo MZHR në koordinim me ministritë e tjera dhe përmes programeve zhvillimore, synon sigurimin e zhvillimit të balancuar dhe sigurimin e kohezionit territorial mes rajoneve zhvillimore në Kosovë.

Në fushën e sigurimit të zhvillimit rajonal të balancuar MZHR poashtu në bashkëpunim me MINT harton dhe zbaton politika për rritjen e zhvillimit ekonomik në zonat e lira ekonomike.

### **Programet e MZHR-së dhe rezultatet**

Përcaktimet programore të MZHR për të siguruar zhvillim të balancuar rajonal bazohen në Strategjinë për Zhvillim Rajonal (2020-2023), duke ju referuar më saktësisht objektivave strategjike dhe objektivave specifike. Zhvillimi i programeve merr parasysh edhe planin e veprimit dhe ndërlidhjet përkatëse me partnerët tjerë institucional (Ministritë, Kryeministrinë, Komunat dhe aktërët tjerë relevant).

Programet e MZHR-së janë të organizuar në tre (3) fusha tematike ku fusha e katërt është shtuar me vendim të qeverisë si pjesë e pakos për rimëkëmbje ekonomike (2020–2021). Përmes këtyre programeve MZHR zhvillon aktivitetet stimuluese dhe mbështetëse për zhvillim të balancuar të rajoneve, përkatësisht zhvillon skema të granteve dhe të financimit në sektorin privat, publik dhe për shoqërinë civile (organizatat e shoqërisë civile).

Përkatësisht programet e rregullta të MZHR-së janë:

- Programi për Zhvillim Rajonal (PZHR);
- Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB);
- Mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Program shtesë që iu është besuar Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për ta implementuar është programi:

- Pakot e Rimëkëmbjes Ekonomike (Masa 8 dhe Masa 15)

### **Programi për Zhvillim Rajonal (PZHR)**


Programi për Zhvillim rajonal mbështet komunat në infrastrukturë fizike me projekte kapitale dhe ka për synim që përmes intervenimit të kontribuojë në krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik rajonal të qëndrueshëm dhe atë në të gjitha rajonet zhvillimore të Kosovës. Gjithashtu PZHR për qëllim promovimin e zhvillimit socio-ekonomik, mjedisor dhe kulturor në mënyrë të balancuar. Me qëllim të plotësimit të informacionit për këtë program, është me rëndësi të thuhet se ky program nënkupton edhe projektet softverike që kanë të bëjnë me menaxhimin e performancës rajonale dhe menaxhimin e projekteve që janë pjesë e këtij programi. Programi për Zhvillim Rajonal përmes intervenimit kontribuon në krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik rajonal të qëndrueshëm dhe atë në të gjitha rajonet zhvillimore të Kosovës.

Rezultatet specifike të pritura nga programi janë përkrahja komunave ashtu që ato të zhvillojnë rolin e tyre udhëheqës në përmirësimin e zhvillimit socio-ekonomik përmes projekteve të cilat kontribuojnë në një apo më shumë prioritetet të listuara në strategjitë e tyre për zhvillimit rajonal/lokal. Llojet e aktiviteteve të mbështetura nga programi **kategorizohen si investime kapitale**, të ndërlidhura me objektivin e përgjithshëm të programit e bashkë me këtë edhe kategoria ekonomike e buxhetit të ndarë.

Kategoritë e aplikimit apo nën programet e përcaktuara nga MZHR për këtë program janë:

1. Projektet e infrastrukturës publike për zhvillim socio-ekonomik rajonal sipas aplikimeve nga komunat;
2. Projektet e infrastrukturës lidhur me zonat ekonomike sipas aplikimeve të komunave;
3. Projektet të bazuara në kërkesat individuale të komunave gjatë gjithë vitit (thirrje e hapur).

PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT FINAL DHE SHPENZIMEVE TE  
PZHR-së PËR VITIN 2018, 2019, 2020, 2021



### **Programi për Mbështetjen e Zhvillimit Rajonal të Balancuar (PZHRB)**

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) është program i bazuar në skemë të financimit (grant) me qëllim të përkrahjes së start up-ve dhe bizneseve ekzistuese fillestare. Ky program ka për objektiv intervenimin në zhvillimin e sektorit privat me qëllim të rritjes së ekonomisë dhe krijimit të vendeve të punës. Synimi kryesor i skemës së granteve për sektorin privat është të mundësojë implementimin e projekteve me potencial biznesor domethënës dhe zgjerimin e aktivitetit biznesor. Më saktësisht është synuar mbështetja për rritjen e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve ekzistuese të cilat veprojnë në sektorët me potencial më të madh për rritje. Në disa raste synimi programor shkon edhe në nivel të nën-sektorëve në kuadër të sektorëve të shënjestruar. Poashtu, mbështetja programore ka për synim edhe ndihmën për bizneset fillestare, duke zgjeruar mbështetjen përtej bizneseve ekzistuese.

Synimi i përgjithshëm i këtij programi është zhvillimi socio-ekonomik rajonal i balancuar përmes zhvillimit të ndërmarrësisë në pesë rajonet zhvillimore të Kosovës, në kuadër të së cilit janë tri synime specifike:

1. Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës me theks të veçantë për të rinjtë;
2. Përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial rritjeje;
3. Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve.


Programi poashtu specifikon fusha apo sektorët specifik dhe nënkuptohet në këtë rast synimi i mbështetjes për ndërmarrjet në sektorët e prodhimit dhe përpunimit, si dhe ato në sektorin komercial.

Objektiva tjera të synuara nga programi janë:

Potenciali për zëvendësim të importeve dhe krijimi i eksporteve duke ju referuar nevojave dhe prioriteteve të mjedisit lokal, në sektorët:

- Prodhim
- Shërbime

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar organizon dhe zbaton skemën e granteve për përkrahje sektorit privat në pesë (5) rajonet zhvillimore dhe buxheti për skemën e këtij programi hyn në kategorinë ekonomike të **subvencioneve dhe transfereve**.



### **Programi për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar**

Programi për mbështetjen e sektorit të shoqërisë civile (OSHC) me qëllim të avancimit të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar bazohet në skemën e ngritur për financimin e këtyrë organizatave dhe aktiviteteve përkatëse në pesë (5) rajonet zhvillimore. Skema bazohet në thirrjen publike për projekt-propozime nga ana e organizatave të shoqërisë civile të cilat projekt-propozime kanë për qëllim avancimin dhe promovimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar. Më saktësisht MZHR shpall thirrjen për organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e zhvillimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar për të aplikuar aplikojnë me projekte për mbështetje financiare me qëllim të përmbushjes së objektivave të mandatit të MZHR-së.

Programi më saktësisht skema e grantit formulon tre (3) objektiva si në vijim dhe nën-objektivat specifike me qëllim të përmbushjes së objektivit përkatës. Tre (3) objektivat e skemës nën këtë program janë:

- 1. Promovimi i Zhvillimit Socio – Ekonomik Rajonal të Balancuar;**
- 2. Nxitja e rrjetëzimeve me qëllim të zhvillimit socio – ekonomik rajonal;**
- 3. Nxitja dhe vetëdijesimi i të rinjve dhe grave në fushën e zhvillimit socio-ekonomik.**


Kursë nën-objektivat, apo objektivat specifike nën objektivin përkatës janë:

- 1. Promovimi i Zhvillimit Socio – Ekonomik Rajonal të Balancuar:**
  - 1.1 Promovimi i politikave të fushës së zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;
  - 1.2 Zhvillimi i kapaciteteve lokale/rajonale për krijimin e ambientit më të favorshëm për biznes në fushën prodhuese dhe zëvendësimin e importit;
  - 1.3 Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve dhe promovimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal;
  - 1.4 Identifikimi i kriterëve për klasifikimin dhe promovimin e brendeve rajonale;
  - 1.5 Avansimi i dialogut ndërmjet MZHR-së, Institucioneve lokale, bizneseve dhe shoqërisë civile.
- 2. Nxitja e rrjetëzimeve me qëllim të zhvillimit socio – ekonomik rajonal**
  - 2.1 Promovimi i formave të bashkëpunimit në kontekst të zhvillimit socio-ekonomik rajonal;
  - 2.2 Nxitja e bashkëpunimit në mes komunës dhe shoqatave të bizneseve, investitorëve dhe ndërmarrësve për zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik rajonal të balancuar.
- 3. Nxitja dhe vetëdijesimi i të rinjve dhe grave në fushën e zhvillimit socio-ekonomik**
  - 3.1 Identifikimi i fushave potenciale për zhvillim socio-ekonomik dhe promovimi tek të rinjtë dhe gratë;
  - 3.2 Ngritja e kapaciteteve për të rinjtë dhe gratë lidhur me hartimin e projekteve dhe realizimin e procedurave për aplikim në fonde vendore dhe ndërkombëtare.

Programi për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar organizon dhe zbaton skemën e granteve për përkrahje shoqërisë civile (OSHC) në tërë Kosovën nënkuptohen pesë (5) rajonet zhvillimore dhe buxheti për skemën e këtij programi hyn në kategorinë ekonomike të **subvencioneve dhe transfereve**.



PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT FINAL DHE SHPENZIMEVE TE PROGRAMIT PËR MBËSHTETJEN E OSHC- ve PËR VITIN 2018, 2019, 2020, 2021



### Programi për Rimekëmbje Ekonomike nga pasojat e pandemisë me COVID 19 – Masa 8 dhe Masa 15


Si pasojë e efekteve negative që janë krijuar tek sektori privat nga pandemia Covid 19 MZHR ka implementuar Masën 8 në v. 2020 dhe Masën 15 në v.2021 nga Pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike. Pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike ka derivuar nga Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar në Qeveri më 05.06.2020 me nr.01/02 dhe ka pasë për qëllim ruajtjen e shëndetit publik dhe ekonomik të vendit.

Ministria e Zhvillimit Rajonal është angazhuar për të kontribuar në këto pako dhe ka planifikuar të jetë pjesë e Masës 8 të aprovuar me vendimin e qeverisë Nr.01/23 datë 13.08.2020. Masa 8 e pakos specifikon, “Mbështetje për programe ekzistuese dhe të reja që lidhen me zhvillimin rajonal përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, që ndikojnë në zhvillimin e balancuar rajonal në vlerë prej 2 milionë euro”. Rrjedhimisht autorizon MZHR-në për zbatimin e masës së bashku me ndarjen buxhetore prej EUR 2 milion, të cilat MZHR i ka zbatuar përmes programit të veçantë dhe skemës së dedikuar për Masën 8. Ndersa Masa 15 është implementuar në v. 2021 në vlerë prej 963,857 Euro ku Ministria e Zhvillimit Rajonal është përcaktuar përseri përgjegjëse për zbatimin e Masës 15 për “Mbështetjen e programve ekzistuese që lidhen me zhvillimin rajonal e që ndikojnë në zhvillimin rajonal të balancuar.

Si program i jashtëzakonshëm i krijuar në rrethanat e paprecedent të pandemisë me COVID 19, programi fillon në vitin 2020 dhe zbatohet edhe në vitin 2021. Buxheti për skemën e këtij programi hyn në kategorinë ekonomike të **subvencioneve dhe transfereve**.

Buxheti i ndarë për këtë program për periudhën 2020 – 2021 është dhënë në tabelën më poshtë.

PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT FINAL DHE SHPENZIMEVE TE PROGRAMIT PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE (MASA 8 DHE 15) PËR PERIUDHËN 2020 - 2021



Mesatarja e buxhetit në baza vjetore është EUR 1.5 milion ku në vitin e parë 2020 ndarja buxhetore është EUR 2 milion dhe në vitin pasues ulet në EUR 1 milion.

Totali i buxhetit për MASËN-8 të Rimëkëmbjes për periudhën 2020 – 2021 shkon në EUR 3 milion, duke ofruar kështu një shumë të konsiderueshme për intervenim në sektorët e synuara të ekonomisë në funksion të mbrojtjes, sigurimit të qëndrueshmërisë dhe avancimit të interesave për zhvillim socio-ekonomik të balancuar rajonal. Buxheti i ndarë është menduar në kontekst të kufizimit të dëmeve dhe problemeve me të cilat janë ballafaquar bizneset si rezultat i masave për kufizimin e shpërndarjes së infeksionit COVID-19 (mbyllje e përgjithshme dhe e pjesërishtme e sektorëve, kufizimi i lëvizjes, etj.).

Realizimi i buxhetit në kuadër të programit sillet në masën 99% si mesatare për 2 vite apo në total afër EUR 3 milion.

## Përmbledhja e programeve dhe buxheteve

Në tabelat e mëposhtme janë të përmbledhura buxhetet dhe normat e realizimit veç e veç për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, ndërsa në tabelën e fundit është i përmbledhur buxheti fillestar, ndryshimet e buxheti gjatë vitit, buxheti final, shpenzimet si dhe shkalla e realizimit e shprehur në përqindje për vitet 2018-2021.

Vlera totale e buxhetit fillestar të programeve të MZHR-së për vitet 2018-2021 është: Programi për zhvillim Rajonal: 8,400,000.00€, Programi për zhvillim Rajonal të Balancuar dhe Programi për mbështetjen e Organizatave të Shoqërisë Civile: 7,400,000.00€ gjithësej buxheti fillestar për këto programe është:15,800,000.00€. Mirëpo gjatë viteve buxheti i programeve të MZHR-së ka pësuar ndryshime. Kështu që buxheti final për programet e MZHR-së për vitet 2018-2021 është: Programi për zhvillim Rajonal: 7,171,830.43€, programet që financohen nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere (Programi për zhvillim Rajonal të balancuar dhe programi për mbështetjen e Organizatave të Shoqërisë Civile: 6,479,118.10€ dhe Programi për Rimëkembje Ekonomike (Masa 8 dhe 15) në vlerë prej 3,000,000.00€. Gjithësej buxheti final për këto programe është:16,650,948.53€.

Ndërsa sa iu përket shpenzimeve dhe realizimit të shprehur në përqindje këmi këto të dhëna të përmbledhura për vitet 2018-2021:

- Programi për Zhvillim Rajonal: 6,271,310.00€ ose 87.44%;
- Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 6,083,142.00€ ose 99.30%;
- Programi për mbështetjen e Organizatave të Shoqërisë Civile: 319,824.00€ ose 90.59%;
- Programi për Rimëkembje Ekonomike (Masa 8 dhe 15): 2,971,906.00€ ose 99.06%.

Gjithësej shpenzimet e këtyre programeve për vitet 2018-2021 janë: 15,646,182.00€ dhe realizimi i buxhetit i shprehur në përqindje për vitet 2018-2021 është 93.97%. Vlera e arritur e programeve për këtë periudhë demonstroi në formë të agreguar shkallën e realizuar të aktiviteteve për zhvillim socio – ekonomik të balancuar të rajoneve, si dhe promovimin e zhvillimit socio – ekonomik të rajoneve zhvillimore.

Përmbledhja e buxheteve dhe realizimeve të programve zhvillimore për zhvillim socio – ekonomik të balancuar të rajoneve është dhënë në tabelat më poshtë.

PROGRAMET E MZHR-së	BUXHETI I PROGRAMEVE TE MZHR-së PËR VITIN 2018				
	BUXHETI FILLESTAR	NDRYSHIMI I BUXHETIT NDARJE DHE KURSIMIT	BUXHETI FINAL	SHPENZIMET	REALIZIMI NE %
PZHR	2,000,000.00	465,045.64	1,534,753.96	1,534,754.00	100.00
PZHRB	1,500,000.00	14,401.32	1,370,918.68	1,359,723.00	99.18
PROG - OSHC			114,680.00	87,456.00	76.26
TOTALI I PROGRAMEVE TE MZHR-së	3,500,000.00	479,446.96	3,020,352.64	2,981,933.00	98.73
	BUXHETI I PROGRAMEVE TE MZHR-së PËR VITIN 2019				

PROGRAMET E MZHR-së	BUXHETI FILLESTAR	NDRYSHIMI I BUXHETIT NDARJE DHE KURSIMET	BUXHETI FINAL	SHPENZIMET	REALIZIMI NE %
PZHR	2,700,000.00	78,194.38	2,621,805.62	2,010,551.00	76.69
PZHRB	2,500,000.00	2,940.00	2,422,768.00	2,398,249.00	98.99
PROG - OSHC			74,292.00	74,292.00	100.00
TOTALI I PROGRAMEVE TE MZHR-së	5,200,000.00	81,134.38	5,118,865.62	4,483,092.00	87.58
<b>BUXHETI I PROGRAMEVE TE MZHR-së PËR VITIN 2020</b>					
PROGRAMET E MZHR-së	BUXHETI FILLESTAR	NDRYSHIMI I BUXHETIT NDARJE DHE KURSIMET	BUXHETI FINAL	SHPENZIMET	REALIZIMI NE %
PZHR	2,500,000.00	350,000.00	2,150,000.00	1,871,799.00	87.06
PZHRB	2,500,000.00	903,540.58	1,536,459.42	1,537,615.00	100.08
PROG - OSHC			60,000.00	53,990.00	89.98
PRE MASA - 8	-	-	2,000,000.00	1,984,349.00	99.22
TOTALI I PROGRAMEVE TE MZHR-së	5,000,000.00	1,253,540.58	5,746,459.42	5,447,753.00	94.80
<b>BUXHETI I PROGRAMEVE TE MZHR-së PËR VITIN 2021</b>					
PROGRAMET E MZHR-së	BUXHETI FILLESTAR	NDRYSHIMI I BUXHETIT NDARJE DHE KURSIMET	BUXHETI FINAL	SHPENZIMET	REALIZIMI NE %
PZHR	1,200,000.00	334,729.15	865,270.85	854,206.00	98.72
PZHRB	900,000.00	-	795,914.00	787,555.00	98.95
PROG - OSHC			104,086.00	104,086.00	100.00
PRE MASA - 15	-	-	1,000,000.00	987,557.00	98.76
TOTALI I PROGRAMEVE TE MZHR-së	2,100,000.00	334,729.15	2,765,270.85	2,733,404.00	98.85
<b>BUXHETI I PROGRAMEVE TE MZHR-së PËR VITIN 2018, 2019, 2020, 2021</b>					
PROGRAMET E MZHR-së	BUXHETI FILLESTAR	NDRYSHIMI I BUXHETIT NDARJE DHE KURSIMET	BUXHETI FINAL	SHPENZIMET	REALIZIMI NE %
PZHR	8,400,000.00	1,227,969.17	7,171,830.43	6,271,310.00	87.44
PZHRB	7,400,000.00	920,881.90	6,126,060.10	6,083,142.00	99.30
PROG - OSHC			353,058.00	319,824.00	90.59
PRE MASA - 8 DHE 15	-	-	3,000,000.00	2,971,906.00	99.06
TOTALI I PROGRAMEVE TE MZHR-së	15,800,000.00	2,148,851.07	16,650,948.53	15,646,182.00	93.97

MZHR në kuadër të planit të punës ka zhvilluar aktivitetet për ngritjen e sistemit të monitorimit të sistemit për matjen dhe vlerësimin e shkallës së zhvillimit socio – ekonomik në nivel të rajoneve zhvillimore duke ngritur grupin punues përkatës. Ngritja e sistemit për monitorim është e elaboruar më tutje në seksionin bashkëpunimi me akterët e tjerë, nënkëpitulli Organizatata tjera!

### **Struktura e MZHR-së dhe arritjet**

Struktura organizative e MZHR-së është zhvilluar në pajtim me aktin rregullues, Rregullore (QRK) Nr.02/2021 për fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, e cila përcakton mandatin e MZHR-së.


Më saktësisht, sipas këtij vendimi të qeverisë MZHR-ja ka këto përgjegjësi:

- Përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, miratimin e akteve nënligjore dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e zhvillimit rajonal dhe zbatimin e tyre;
- Në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për punë të jashtme dhe diasporë dhe me ministrinë e përkatëse, zhvillon dhe merr pjesë në nismat dhe programet rajonale sa i përket fushës së zhvillimit rajonal;
- Planifikon dhe zhvillon treguesit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar; Koordinon aktivitetet me institucione të nivelit qendror dhe lokal si dhe akterë tjerë relevant në përkrahje të zhvillimit socioekonomik rajonal të balancuar dhe regjenerimit të vendeve të reja të punës;
- Në bashkëpunim me institucionin përgjegjës për integrim evropian dhe ministrinë përkatëse për financa, dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi merr pjesë në administrimin e ndihmës së huaj financiare në fushën e zhvillimit rajonal;
- Zhvillon dhe menaxhon programe për të ofruar zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe bën promovimin e tyre;
- Bashkërendohet me ministrinë përgjegjëse për tregti dhe industri dhe institucionet e tjera për zhvillimin e zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socioekonomik rajonal të balancuar;
- Në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për tregti dhe industri harton dhe zhvillon kriteret për identifikimin dhe promovimin e brendeve rajonale;
- Përgatit analiza lidhur me zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar;
- Harton raporte vjetore për Qeverinë lidhur me programet dhe iniciativat e zhvillimit rajonal;
- Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi;
- Fusha e përgjegjësisë administrative të kësaj ministrie përfshin zhvillimin socioekonomik rajonal të balancuar në pajtim me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton ndonjë organizim të ri administrativ apo territorial.

## Organizimi i MZHR-së

Në pajtim me mandatin dhe përgjegjësitë e caktuara, MZHR ka këtë organizim institucional. Nivelin politik dhe nivelin administrativ-profesional, niveli politik në kuadër të Kabinetit të Ministrisë (ministri, zv.ministrat, dhe këshilltarët politik).

Niveli administrativ – profesional i cili fillon prej Sekretarit të Përgjithshëm dhe organoizohet në tre (3) shtylla sipas fushave të përgjegjësisë (DZHR, DPASER, DIEKP) dhe në organogram shtylla e 4 paraqet shërbimet e përgjithshme administrative, si dhe njësitë për komunikim, prokurim, auditim të brendshëm dhe divizion ligjor. Sipas publikimit të MZHR-së në faqen e internetit gjithësej janë 54 persona.



Periodha e analizuar lidhur me avancimin e zhvillimit socio-ekonomik të balancuar 2017 – 2021 shquhet me kontekst shumë sfidues, marrë parasysh zhvillimet me pandeminë Covid 19, mbylljet e shumta dhe kufizimet e gjata. Poashtu në aspektin e jetës politike institucionale, Kosova ka mbajtur dy (2) palë zgjedhje të përgjithshme dhe një (1) palë lokale e me to lidhen edhe proceset e formimit të institucioneve.

Në MZHR, gjatë periudhës 2017 – 2021 janë ndërruar katër (4) Ministra:

- Aktualisht nga v.2021 – z. Fikrim Damka
- Në vitin 2020 – z. Milan Milojević
- Në vitin 2019 – z. Enis Kervan
- Në vitin 2018 – z. Rasim Demiri

Zhvillimet politike ndonëse nuk kanë pasur ndikim në zbatimin e mandatit, kufizimet nga pandemia gjithësej kanë ndikuar në uljen e dinamikës së aktiviteteve qoftë në anën e vet MZHR-së si dhe në anën tjetër.

## **Arritjet e MZHR-së në avancimin e zhvillimit rajonal**

MZHR gjatë periudhës 2017 – 2021 ka kaluar prej pikës fillestare (themeluar në vitin 2017, aktivitetet prej 2018) deri tek zbatimi i suksesshem i katër (4) xhirove të programeve zhvillimore vjetore, PZHR, PZHRB dhe programi për mbështetje të OSHC. Arritjet e MZHR-së në avancimin e zhvillimit rajonal mund të kategorizohen sipas fushave specifike të veprimit, ndonëse aktivitetet janë të ndërlidhura si rezultat i ndërveprimit të menduar të intervenimit përmes aktiviteteve për zhvillim rajonal të balancuar. Përkatësisht rezultatat e MZHR-së kategorizohen sipas fushave të veprimit:

- Kuadri institucional dhe trupat për planifikimin, koordinimin, hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillim rajonal të balancuar;
- Politikat, planet dhe kuadri ligjor;
- Masat dhe aktivitetet programore për zhvillim rajonal të balancuar.

## **Ngritja e kuadrit institucional dhe trupave koordinuese**

Në kontekst të ngritjes së kuadrit institucional është vet MZHR me strukturën e vet organizative e cila është themeluar në vitin 2017 dhe fillon me funksionim prej vitit 2018 e cila është bartëse e aktiviteteve për krijimin e trupave koordinuese dhe planifikim, si dhe zbatim të politikave për zhvillim rajonal të balancuar. Poashtu vet MZHR dhe trupat e krijuara përfaqësojnë arritje në kuadër të kërkesave drejt integritimeve Europiane në përmbushje të dispozitave nga MSA, shih kapitullin Korniza e akteve, mekanizmave dhe veprimeve.

Në vijim shpalosen disa nga aktivitetet me rëndësi në kontekst të këtij raporti pasi që MZHR ka zhvilluar shumë aktivitetete.

- Në vitin 2018, MZHR krijon grupin punues përgjegjës për hartimin e dokumentit, Profilet e rajoneve zhvillimore;
- Në vitin 2019, MZHR ka ngritë grupin punues për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020-2030, ku ky grup punues ka qenë i përbërë edhe nga akterë të Ministrive të Linjës, akterëve lokal dhe shoqërisë civile dhe është mbështetur nga Qeveria e Norvegjisë dhe zbatimi është mbështetur edhe nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ);
- Në vitin 2020, MZHR ngrit grupin punues për hartimin e Analizës për Funksionimin e Zonave Ekonomike në Kosovë për v.2019;
- Në vitin 2020 MZHR ka themeluar mekanizmat raportues në nivelin qendror (Ministri të Linjes, Ministri të Financave dhe ASK) për pranimin e të dhenave, raporteve në funksion të zhvillimit rajonal të balancuar;
- Në vitin 2021, MZHR ngrit bashkëpunimin me Universitetin e Shkencave Aplikative në Ferizaj me qëllim të ngritjes së sistemit për monitorimin dhe vlerësimin e shkallës së zhvillimit socio – ekonomik të rajoneve zhvillimore;
- Projektligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar ( i aprovuar në Qeverinë e Kosovës);
- Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare për Zhvillim Rajonal, KNZHR 24-25 Mars 2022, ndonëse si arritje është jashtë kornizës kohore së kësaj analize, meqenë se mbajtja e konferencës korrespondon me kohën e hartimit të këtij raporti, vlenë të shënohet si arritje e MZHR-së. Kjo për shkak se ka rëndësi të madhe duke marrë parasysh se konferenca është e para e këtij formati, ku synim kryesor ka forcimin e komunikimit, rritjen e bashkëpunimit mes vendeve të rajonit (Ballkanit Perëndimor) dhe vendeve të BE-së, përmes ndarjes së informacionit, përvojave dhe ideve në politikat/legjislacionin, praktikave në këtë fushë.

Njohja me strukturën e organizimit të rajoneve, mekanizmave zbatues dhe programeve që i kontribuojnë zhvillimit rajonal;

- Nënshkrimi i shumë memorandumeve të bashkëpunimit për të avancuar zhvillimin e balancuar rajonal me Universitete (Marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin Hasan Prishtina), Organizata vendore dhe ndërkombëtare (GIZ, UNICEF, BERZH, CARITASI ZVICERAN, OTKT, UN-HBITAT, etj), si dhe shtete fqinje si: ( Maqedoninë e Veriut, Republikën e Turqisë, Republikën e Kroacisë, Republikën e Bullgarisë).

## **Politikat, planet dhe kuadri ligjor**

Arritjet në aspektin e formulimit të legjislacionit, hartimit të politikave dhe planeve MZHR ka një sukses të mirëfilltë gjatë periudhës 2018 – 2021. Më poshtë paraqiten në format kronologjik këto dokumente:

- Koncept dokumenti i vitit 2018, [Koncept Dokument – Zhvillimi Rajonal në Kosovë, Korrik 2018];
- Strategjia për zhvillim rajonal e vitit 2020, [Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020 – 2030];
- Projektligji për zhvillim rajonal të balancuar i vitit 2022, [Projektligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar], ndonëse ky projektligj është në fazat përfundimtare para paraqitjes në Kuvend të Kosovës.

Në këtë kontekst, si arritje e MZHR është edhe bashkëpunimi dhe hartimi i memorandumeve me akterë të ndryshëm:

- Në vitin 2018, MZHR ka nënshkruar memorandumet e para me kryetarët e komunave në fushën e zhvillimit rajonal të balancuar;
- <sup>16</sup>Në vitin 2019, MZHR në kuadër të avancimit të zhvillimit rajonal ka hartuar dokumentin “Studimi dhe dizajnimi i sistemit për monitorimin e zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar” me 14 fusha dhe 93 tregues për matjen dhe vlerësimin e zhvillimit rajonal socio-ekonomik dhe në punëtori të përbashkët ky dokument është shqyrtuar dhe diskutuar me ministrinë e linjave, komuna si dhe me Agjencionin e Statistikave të Kosovës si trup përgjegjës për mbledhjen, përpunimin, dhe publikimin e këtyre parametrave;
- Në vitin 2021, MZHR ka nënshkruar marrëveshjet për zbatimin e Programit për Zhvillim Rajonal, Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe Masave nga Programi për Rimëkëmbje; Zbatimi i Programit për bashkëpunim me OSHC.

Gjithashtu arritje e MZHR-së në avancimin e zhvillimit rajonal janë edhe hartimet e raporteve analitike, vjetore si dhe ato shumëvjeçare:

- Analizë vjetore e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar (2018; 2019; 2018-2020, 2021);
- Analizë vjetore e investimeve kapitale sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë (2018; 2019; 2018 – 2020, 2021);
- Profilet e Rajoneve Zhvillimore, si dhe publikimet e tjera në faqen zyrtare të MZHR-së;
- Analiza për funksionimin e zonave ekonomike në Kosovë (2019) dhe (2022);

---

<sup>16</sup> [mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/F7064850-9D11-4CCE-8EED-BE825D58BDFF.pdf](https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/F7064850-9D11-4CCE-8EED-BE825D58BDFF.pdf)



- Në vitin 2022 ,MZHR ka hartuar dokumentin shpejgues për hartimin e kriterëve për brendimin e rajoneve zhvillimore ( llogot rajonale)<sup>17</sup>;
- Gjithashtu në v.2022,MZHR ka hartuar dokumentin Pasyrimi inventarizimit të resurseve kulturore sipas rajoneve zhvillimore.<sup>18</sup>

Arritje e veçantë është ueb faqja e MZHR<sup>19</sup>, e cila është e plotësuar dhe përditësuar me informatat relevante në tre gjuhë ( shqip, anglisht dhe serbisht) dhe përmbanë gjithë kuadrin e dokumenteve të nevojshme duke kontribuar kështu në transparencën dhe relevancën e punës së MZHR.

## **Masat dhe aktivitetet programore për zhvillim rajonal të balancuar**

MZHR në zbatim të mandatit sipas përgjegjësi të dhëna dhe në pajtim me kuadrin rregullues sipas MSA dhe legjislacionit vendor ka hartuar dhe zbatuar programe për zhvillim rajonal duke u fokusuar në tre kategori, institucionet e pushtetit lokal, ekonomia (bizneset) dhe sektorin e shoqërisë civile (OSHC). Për katër vite, shih kapitullin Programet e MZHR dhe rezultatet, janë hartuar dhe zbatuar programe në këto kategori socio – ekonomike dhe institucionale dhe rrjedhimisht janë arritë rezultatet e shpalosuar në kapitullin përkatës.

### **Arritjet e tjera të veçuara**

Arritjet në fushën e ngritjes së mekanizmave institucional, sipas përcaktimeve në Aquis, MSA, Koncept dhe Planin Strategjik. (Grupet punuese, hartimi i politikave, ngritja e mekanizmave për monitorim të performancës, pregatitja e ligjit).

- Në vitin 2017, organizon takimin e parë me organizatat donatore në Kosovë dhe vendos fillet e bashkëpunimit institucional, koordinimim dhe planifikimin për aktivitetet në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë;
- Në vitin 2018, MZHR organizon seri takimesh me palët e interesit dhe bashkëpunonëtorët prej nivelit ndërkombëtar, institucione publike si dhe akterë të sektorit privat si dhe merr pjesë në aktivitetet e organizuara nga BE në fushën e integritimeve Europiane;
- Koordinimi MZHR – Ministri e Industrisë dhe Teknologjise e R.Turqisë, në hartimin e tre (3) projekt propozimeve sipas përvojës së sukseshme me fondet e BE (IPA).

### **Bashkëpunimi me akteret tjerë**

Në zbatimin e mandatit MZHR zhvillon bashkëpunime me një brez të gjerë akteresh puna e të cilëve ndërlidhet me fushëveprimin e saj, dhe si rrjedhim zhvillohen aktivitetet e bashkëpunimit dhe të koordinimit. Me qëllim të klasifikimit akterët janë të oranzuar në grupin e donatorëve dhe institucionet vendore (Ministritë, Komunat, AZHR-të dhe OSHC-të).

Përshkrim i përfshirjes së organizatave të tjera në aktivitetet e MZHR.

### **Donatorët**

Në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit me komunitetin e donatorëve në Kosovë, MZHR zhvillon dhe merr pjesë aktive në formulimin e politikave si dhe zbatimin e tyre në kontekst të projeteve

<sup>17</sup> 7DF1223F-423E-4380-BEE5-614977121AD1.pdf (rks-gov.net)

<sup>18</sup> pasqyrimi i INVENTARIZIMIT TË resurseve kulturore në rajone zhvillimore (rks-gov.net)

<sup>19</sup> <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,7>

vetanake apo të donatorëve kur ato i takojnë përgjegjësive në kuadër të fushëveprimit të MZHR-së.  
Bashkëpunimi me organizatat donatore paraqitet në tabelën në vijim:

Nr.	Emri I organizates	Viti i bashkepunimit, kohezgjatja	Fusha e bashkepunimit	Statusi (perfunduar, vijon, e planifikuar)	Emri I projektit - ne MZHR, pershkrimi i qellimit (trajtime, grante, grupe specifike gra minoritete...)	Rezultatet - Arritjet
1	CARITAS	2021/2024	Mbështetje në promovimin e zhvillimit socio ekonomik dhe aktivitete në zbatimin e projekteve të përbashkëta Yeni dhe Mardi në avancimin e zhvillimit rajonal socio-ekonomik në Kosovë, duke synuar përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin e ndërsjellë. Duke përfshirë fushat e bashkëpunimit në çështjet e Integritimit gjenerimit të të ardhurave dhe ndryshimeve klimatike duke siguruar shkëmbimin e përvojës përfaqësuar interesin publik dhe interesat e përbashkëta në shërbim të zhvillimit të marrëdhënieve dhe politikave që synojnë rritjen e zhvillimit të ekuilibruar rajonal.	Vijon	Yeni- Youth Environmental Impact MARDI-Municipal Action for Reintegration and Diaspora	Bashkëpunimi është lansuar në v.2022 Yeni: (15) Komuna përfituese/DKA, (56) shkolla, (344) nxënës/ mësimdhënës, (4) trajner, lansimi i thirrjes “Ndikimi i rinisë në mjedis”. Mardi:(11) Komuna përfituese, lansimi I thirrjes “Projektet investuese të Diasporës” dhe “Ri-integrimi ekonomik I personave të riatdhesuar dhe të huajve”
2	GIZ-it	Periudhë afatmesme tri vjeçare (2021-2024)	Ngrita e promovimit të zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar. Mbështetje teknike përmes konsulencës.	Vijon	Hartimi i legjislacionit dhe promovimi socio-ekonomik rajonal Mbështetja teknike përmes konsulencës	Përgatitja e formatit (modelit) të raportimit vjetor të Implementimit të Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020-2030. Ekspetiza në hartimin e projekt ligjit për zhvillim rajonal të balancuar dhe dokumenteve analitike në funksion të avancimit të zhvillimit të balancuar rajonal përfshirë draftimin e grupit të treguesve për ambient dhe zhvillim rajonal. Pjesmarrja e MZHR-së 2022 në KSDW(Kosovo Sustainable Development Week).
3	UN HBITAT	Periudha 2021-2023	Avancimi dhe promovimi i konceptit të bashkëpunimit rajonal, ndërkomunal në nivelin lokal përmes punëtorive të përbashkëta.	Vijon		Realizimi I katër (4) puntorive për promovimin e bashkëpunimit ndërkomunal në nivelin lokal. Mbështetja në hartimin e Planit të Veprimit të Startegjisë 2023-2025 Avancimi I Uhdzuesit për Investime kapitale për v.2022

4	<b>UNICEF</b>	2020-2021	Fuqizimi i të rinjve përmes “Programit praktikë në punë”, që do ju mundësoj atyre kalimin më të lehtë nga shkolla në punë, në të gjitha rajonet zhvillimore të Kosovës	I përfunduar	“Programit praktikë në punë”.	Angazhimi i 40 praktikantëve në bashkëfinancim me UNICEF në bizneset përfituese të mbështetura nga MZHR përmes PZHRB-së.
5	<b>BERZH</b>	2020-2022	Avancimi dhe promovimi i konceptit të bashkëpunimit rajonal, ndërkomunal në nivelin lokal përmes punëtorive të përbashkëta. Mbështetje në ndërtimin e kapaciteteve, trajnime për të përmirësuar pozicionin konkurrues, produktivitetin dhe zhvillimin e bizneseve	Vijon	A) Shitja online dhe menaxhimi I rrjeteve sociale – Fund Nëntor/Fillim Dhjetor 2021 B) Manaxhimi financave dhe raportimi financiar – Janar, 2022	Realizimi I sesioneve informuese MZHR-BERZH me aplikuesit e PZHRB për mënyrat e aplikimit për thirrjet e MZHR-së kanë marrë pjesë 260 pjesëmarrës Realizimi i trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve me BERZH në menaxhimin e projekteve dhe menaxhim financiar. Në kuadër të bashkëpunimit janë Certifikuar 40 përfitues.
6	<b>OTKT</b>	2021-2022	Mbështetje në promovimin e bizneseve	Vijon	Zhvillimi i projekteve dhe aktiviteteve si dhe shkëmbimi I përvojave të ndërsjellëta.	Dizajnimi dhe publikimi i katalogjeve promovuese nga Skema e Granteve Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (2018-2021)
7	<b>OEK</b>	2021 - 2022	Mbështetje në promovimin e bizneseve	Vijon	Konsultime dhe këshillime lidhur me thirrjet e Programeve për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe Konsultime dhe këshillime lidhur me thirrjet e Programeve për Rimëkëmbje ekonomike MASA 8 dhe MASA 15,	Nr. i pa pacaktuar i përfituesve
8	<b>Klubi i Prodhuesve</b>	2020 - 2021	Mbështetje në promovimin e bizneseve	Përfunduar	Konsultime dhe këshillime lidhur me thirrjet e Programeve për Rimëkëmbje ekonomike MASA 8	Nr. i pa përcaktuar i përfituesve
9	<b>KLGI</b>	2018 -2022	Mbështetje në promovimin e zhvillimit rajonal, bashkëpunimit rajonal, ndërkomunal në nivelin lokal.	Përfunduar	Punëtori, ekspertizë financiare tryeza, sesione informuese etj.	Realizimi dhe mbështetja financiare e Puntorive për hartimine Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020-2023

						<p>Ekspertizë financiar për hartimine projektligjit për zhvillim rajonal të balancuar</p> <p>Mbështetja e puntorive ndërvite për validimin e të dhënave nga niveli qendror dhe lokal për hartimin e Anlizës për Investime Kapitale nga niveli qendror dhe lokal.</p>
--	--	--	--	--	--	--

## **Institucionet vendore**

Duke marrë parasysh se zhvillimi socio – ekonomik rajonal të balancuar i cili nënkupton një brez të gjërë të aspekteve zhvillimore dhe se Ministrinë e Linjave të tjera poashtu kontribuojnë në zhvillim duke hartuar dhe zbatuar politika në kuadër të fushëveprimeve përkatëse, kjo nënkupton ndërlidhjen me MZHR-së në kuptimin e zbatimit të mandatit për koordinimin e politikave zhvillimore. Në kontekst të bashkëpunimit me institucionet tjera, MZHR ka ngritë grupe punuese dhe zhvilluar takime pune të rregullta, poashtu edhe është pjesë e grupeve punuese të Ministrive tjera. Hartimi i planit strategjik për Zhvillim Rajonal 2020 – 2030, si proces është zhvilluar përmes qasjes së gjërë konsultative, me të gjitha Ministrinë e Linjës me qëllim të sigurimit të perspektives, kompetencës, dhe sigurimit të koordinimit në mes të instancave më të larta përgjegjëse në kuadër të mandateve që kanë.

Ndërlidhja poashtu nënkuptohet edhe në mes të MZHR-së dhe pushtetit lokal (komunave), ku poashtu pjesëmarrja apo përfaqësimi i interesave të pushtetit lokal (komunave) është zhvilluar përmes pjesëmarrjes së Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK). Përkatësisht, Strategjia për Zhvillim Rajonal ka konsultuar edhe nivelin lokal përmes AKK-së.

## **Ministrinë e Linjës**

Ndonëse në nivel të planifikimit dhe koordinimit përfshirja e Ministrive të Linjës është gjithëpërfshirës në aspektin e zbatimit të politikave MZHR ka bashkëpunim të ngushtë me:

- Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Ministrinë e Industrisë, Tregtisë dhe Inovacionit;
- Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Bashkëpunimi më këto ministri ndërlidhet edhe me përgjegjësitë që ka MZHR, duke qenë se programet e zhvillimit socio – ekonomik ndërlidhen dhe kordinohen vazhdimisht me nivelin qëndror. Konkretisht, me MINT bashkëpunimi ndërlidhet me grantet për zhvillimin e sektorit privat, përkatësisht programi PZHRB si dhe zbatimi i MASËS 8 dhe MASES 15 e me tutje edhe mbështetjet për zhvillimin e zonave ekonomike. Niveli i bashkëpunimit dhe ndërlidhjes me MINT/KIESA pasqyrohet në rastin e hartimit të dokumentit, *Analiza funksionimit të zonave ekonomike në Kosovë*, ku për bazë studimi janë zonat ekonomike si dhe planet për zona ekonomike të cilat shqyrtohen dhe zbatohen nga ana e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësë, Tregtisë dhe Industrisë. Përkatësisht, PZHR i cili mbështet institucionet e pushtetit lokal në zhvillimin socio – ekonomik të balancuar, koordinimi ndërlidhet me MAPL si dhe me AZHR-të. MZHR ka themeluar mekanizmat mbështetes / raportues në nivelin qëndror të cilët mbështetin MZHR- në me gjitha të dhenat statistikore relevante në funksion të zhvillimit rajonal të balancuar.

Poashtu, aspekti i buxhetimit hartimi dhe zbatimi i programve zhvillimore, implikon bashkëpunimin me MFPT. Kjo nuk nënkupton se MZHR ka bashkëpunim vetëm më këto ministri të linjës, pasi që bashkëpunimi është i rregullt edhe me shumë ministri të tjera si: MBPZHR, MKRS, MASHT, MMPHI,MPJ, MPB, etj.

## **Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK)**

Bashkëpunimi me Agjensionin e Statistikave të Kosovës për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal është qenësor meqenëse agregimi i të gjitha të dhënave për identifikimin e pabarazive rajonale në fusha të ndryshme sociale dhe ekonomike, hartimin e analizave socio ekonomike dhe në funksion e

avancimit të sistemit për matjen e performances rajonale lidhet me Agjencionin e Statistikave të Kosovës. MZHR ka themeluar mekanizmat mbështetës / raportues në ASK të cilët mbështesin MZHR- në më të gjitha të dhënat statistikore relevante në funksion të zhvillimit rajonal të balancuar.

## **Komunat**

MZHR bashkëpunon me të gjitha komunat si pjesë e ushtrimit të mandatit, ku komunat edhe janë pjesë përbërëse e rajoneve zhvillimore si dhe institucione përgjegjëse në kuadër të Agjencioneve për Zhvillim Rajonal (AZHR-ve). MZHR ka memorandume të nënshkruara të mirëkuptimit, posaçërisht në kontekst të zbatimit të programeve zhvillimore në rajone nga ana e MZHR-së. Në proceset e analizës dhe monitorimit të zhvillimit socio – ekonomik, komunat paraqesin njësinë elementare si blloqe ndërtuese të rajoneve zhvillimore (pasi që rajoni zhvillimor nuk ekziston në kuptimin e trupit administrativ). Bashkëpunim të ngushtë specifikisht në hartimin e analizave vjetore duhet të veçohet me Drejtoritë për Zhvillim Ekonomik si bartëse të të gjitha të dhënave të nevojshme për të pasqyruar zhvillimin e balancuar sipas rajoneve/komunave.

## **Agjensionet për Zhvillim Rajonal (AZHR-të)**

Themelimi i strukturave për mbështetjen e zhvillimit të balancuar rajonal në Kosovë është drejtpërdrejt i ndërlidhur me iniciativën e Zyrës së BE-së në Kosovë për të mbështetur krijimin e rrjetit të Agjencive për Zhvillim Rajonal në vitin 2009, në përputhje me Politikën Rajonale të BE-së, si masë për të siguruar zhvillim ekonomik të balancuar në të gjitha rajonet e Kosovës. Kjo iniciativë asokohe është zbatuar me mbështetjen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në koordinim me autoritetet e pushtetit lokal. Kjo rezultoi në themelimin e pesë OJQ-ve të quajtura Agjenci për Zhvillim Rajonal, përkatësisht AZHR-Qendër, AZHR-Lindje, AZHR-Jug, AZHR-Perëndim dhe AZHR-Veri, ku secila nga to mbulonte zonat përkatëse ekonomike të përbëra nga një numër i caktuar i Komunave. Nga aspekti ligjor dhe administrativ, AZHR-të ishin themeluar nga Komunat e zonave ekonomike përkatëse si rezultat i pesë marrëveshjeve ndër-komunale, dhe njëkohësisht sipas statutit të këtyre organizatave anëtarë të Bordeve Qeverisëse të tyre ishin vendosur Kryetarët e Komunave të secilit rajon përkatës.

Për një periudhë të konsiderueshme kohe nga 2009 e tutje, Zyra e BE-së mbështeti financiarisht funksionimin e rrjetit të AZHR-ve me grante operationale, me qëllim të zbatimit të Programit të BE-së për Zhvillim Ekonomik Rajonal. Detyra primare e rrjetit të AZHR-ve fillimisht ishte zhvillimi i pesë Strategjive për Zhvillim Rajonal në rajonet e tyre përkatëse, si dhe Planet e Zbatimit të këtyre dokumenteve strategjike, me qëllim që këto të shërbejnë si bazë e informatave për hartimin e Thirrjeve për Propozime të programit të lartcekur të BE-së, si dhe orientimin e investimeve tjera zhvillimore. Për t'i zhvilluar këto dokumente strategjike dhe zbatuese, secila AZHR është dashur të mobilizoi grupe të zgjeruara të hisedarëve të ndryshme në rajonet e tyre përkatëse, të cilat më pas janë strukturuar në Grupet Thelbësore Punuese të Partneritetit, një numër të Grupeve Punuese Tematike, si dhe në Forume Rajonale. Këto struktura kanë përfshirë departamente të ndryshme të autoriteteve lokale, OSHC të ndryshme që përfaqësonin çështjet e zhvillimit të komuniteteve, rininë, gratë, trashëgiminë kulturore, mbrojtjen e ambientit etj., si dhe komunitetin e biznesit dhe ndërmarrës të ndryshëm, kontributi i të cilëve ishte inkorporuar në këto dokumente strategjike.

Si rrjedhojë e kësaj pune në pesë rajone të ndryshme, Zyra e BE-së përfshiu si kritere specifike në Thirrjet për Propozime të Programit për Zhvillimin Ekonomik Rajonal që u zbatua nga 2010-2016,

të cilat përcaktonin se projektet e financuara nga ky program duhet të ishin në përputhje me synimet strategjike të Strategjive për Zhvillim Rajonal në rajonet ku ato projekte zbatoheshin. Në total përmes këtij programi u realizuan 56 projekte të ndryshme me vlerë mbi 21 milion Euro, të zbatuara nga Komunitat dhe organizatat e tjera partnere.

Rol tjetër i rrjetit të AZHR-ve gjatë kësaj periudhe ishte edhe ngritja e kapacitete në zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve sipas metodologjisë së BE-së, për të cilin edhe u zbatua program i vazhdueshëm i trajnimeve që kryesisht përfshinte zyrtar komunal por edhe përfaqësues të organizatave tjera lokale të shoqërisë civile. Gjithashtu, rrjeti i AZHR-ve ofrojë mbështetje për Zyrën e BE-së në monitorin e zbatimit të këtyre 56 projekteve por edhe atyre nga programet e tjera si ai i Zhvillimit Rural, duke grumbulluar informata nga terreni dhe duke organizuar takime mujore koordinuese me zbatuesit e projekteve.

Me evoluimin e rolit të rrjetit të AZHR-ve gjatë viteve vijuese, në fokus të aktiviteteve u vendos edhe mbështetja e drejtpërdrejt e bizneseve dhe investitorëve, ku në mes të shërbimeve të ndryshme mbështetëse për to, u realizua edhe një grant skemë e cila ofroi mbështetje financiare për zhvillimin e 111 bizneseve start-up dhe ekzistuese, me vlerë total prej 1 milion Euro, si pjesë e projektit të përbashkët të rrjetit të AZHR-ve nga viti 2015-2018 me vlerë prej 2.8 milion Euro.

Me përfundimin e mbështetjes së drejtpërdrejt operacionale nga Zyra e BE-së, rrjeti i AZHR-ve nga viti 2018 e tutje vazhdoi me zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme me ndikim në zhvillimin rajonal, e që u financuan nga programe të ndryshme të BE-së dhe donatorë të tjerë, duke përfshirë edhe fondet e Qeverisë së Kosovës, dhe ato të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Më konkretisht, rrjeti i AZHR-ve krijoi bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal menjëherë pas themelimit të saj si ministri, për të cilën ofroi gjatë këtyre viteve mbështetje të vazhdueshme teknike në zhvillimin e dokumenteve strategjike, programeve zhvillimore dhe hartimin e legjislacionit përkatës. Gjithashtu, rrjeti i AZHR-ve në baza vjetore ka zbatuar edhe projekte të financuara nga MZHR në fushën e zhvillimit rajonal të balancuar, si dhe ka mbështetur Komunitat përkatëse në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga MZHR.

Fushëveprimi i AZHR-ve sipas statutit është:

- a) Të ndihmoj zhvillimin ekonomik dhe rigjenerimin rajonal;
- b) Të promovoj efikasitetin, investimet dhe konkurrencën biznesore;
- c) Të promovoj punësimin dhe të zgjeroj aplikimin e aftësive që janë relevante për punësim;
- d) Të kontribuoj drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm
- e) Përkrah komunitat në çështjet e zhvillimit ekonomik rajonal;
- f) Përkrah komunitat në zhvillimin dhe implementimin e politikave të tyre të rritjes ekonomike;
- g) Promovon krijimin e vendeve të reja të punës në territorin e komunave partnere;
- h) Angazhohet për zhvillimin e teknologjisë dhe resurseve humane të nevojshme për zhvillimin ekonomik të zonës;
- i) Ndihmon në krijimin e një ambienti biznesor që është i nevojshëm për krijimin e biznesit dhe atraktiv për investime vendore dhe të jashtme;
- j) Përkrah zhvillimin e bizneseve lokale;
- k) Promovon dhe lehtëson partneritetet publiko private.

Vlen të theksohet se me legjislacionin për zhvillim rajonal të balancuar i cili është tani në proces të miratimit edhe në Kuvend kjo marrëdhënie e bashkëpunimit në mes MZHR-së, rrjetit të AZHR-ve dhe Komunave pritet të zgjerohet tutje në vitet e ardhshme. Projektligji për Zhvillim Rajonal të



Balancuar parasheh ngritjen e shtatë (7) Qendrave për Zhvillim Rajonal, ku themelimi i entiteteve të reja të bazuara në ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar do të krijojë strukturë të re Qendrave për Zhvillim Rajonal.

### **Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të)**

Me organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) apo OJQ-të, AZHR zhvillon bashkëpunim në dy nivele, ato me të cilat ka bashkëpunim horizontal si organizatat donatore me të cilat koordinon projekte zhvillimore për zhvillim rajonal të balancuar, si dhe me organizata OSHC-të të cilat mbështeten nga programi për mbështetje financiare të projekteve/programeve të ojq-ve në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar. Me organizatat me të cilat MZHR ka bashkëpunim në nivel të koordinimit të projekteve (bashkëpunim në vijë horizontale), janë të listuara në tabelën më lartë ku paraqiten bashkëpunimet, emri i organizatës, fusha e bashkëpunimit – emri i projektit, periudha, dhe rezultatet e arritura.

Kurse me organizatat e OSHC të cilat merren me zbatimin e projekteve të financuara përmes projektit për mbështetje financiare të projekteve/programeve të ojq-ve në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar, janë në numër shumë të madh për tu veçuar në këtë raport. MZHR ka hartuar program për mbështetjen e OSHC për çdo vit, prej vitit 2018.

OSHC-të merren me promovimin e zhvillimit socio – ekonomik të balancuar në rajonet ku veprojnë, duke zbatuar aktivitete të mbështetura nga programet zhvillimore (grantet) e MZHR. Në aspektin financiar lidhur me shumën e financuara dhe realizimi i buxheteve paraqitet në seksionin e analizës së programeve të MZHR më lartë. Poashtu, të dhëna specifike për realizimin dhe rezultatet e skemës për mbështetje të OSHC janë në dispozicion të dokumentit në fjalë.

### **Organizatat tjera**

Në kuadër të ngritjes së kapaciteve, vecohet aktiviteti me Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, me të cilin bashkëpunimi ka sjellë ngritjen e sistemit për përpunim të të dhënave si dhe zhvillimin e sistemit për monitorim të zhvillimit socio-ekonomik. Përmes këtij bashkëpunimi i cili është planifikuar për periudhën 2021 – 2023 është paraparë ngritja e sistemit të monitorimit dhe përpunimit të të dhënave statistikore përmes aplikacionit SPSS, me qëllim të shfrytëzimit nga ana e MZHR-së në proceset e analizës, vendimmarrjes dhe planifikimit të zhvillimit rajonal. Gjatë procesit të bashkëpunimit me USHAF, në vitin 2021 janë trajnuar zyrtarët e MZHR-së për shfrytëzim të aplikacionit SPSS për qëllime të përpunimit të të dhënave për vlerësim dhe monitorim të zhvillimit rajonal përmes IKAP. Në vitin 2022-2023, pritet përfundimi i zhvillimit të sistemit për mbledhje dhe përpunim të të dhënave për vlerësimin dhe matjen e zhvillimit socio – ekonomik rajona, kurse në vitin 2023-2024 pritet funksionalizimi i plotë i sistemit elektronik.